

## Udhëzim

# “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”

### Përmbajtja

A. Hyrje;

B. Koncepti i përqendrimeve ;

I. Përqendrimet ndërmjet ndërmarrjeve të pavarura;

II. Përftimi i kontrollit;

1. Koncepti i kontrollit;

1.1 Personat ose ndërmarrjet që përftojnë kontrollin;

1.2 Mënyrat e kontrollit;

1.3 Objekti i kontrollit;

1.4 Ndryshimi i kontrollit mbi baza të qëndrueshme (lasting basis);

1.5 Transaksione të ndërthurura/ ndërvarura/ ndërlidhura;

1.5.1 Lidhja ndërmjet nenit 10 dhe nenit 15(2) të Ligjit;

1.5.2 Transaksione të pavarura;

1.5.3 Seri të transaksioneve të letrave me vlerë;

1.5.4 Neni 15(2);

1.6 Ristrukturimi i brendshëm;

1.7 Përqendrime që përfshijnë ndërmarrje të zotëruara nga shteti;

2. Kontrolli i vetëm;

3. Kontrolli i përbashkët;

3.1 Barazia në të drejtat e votës ose në caktimin e organeve vendimmarrëse;

3.2 Të drejtat e vetos;

3.3 Ushtrimi i përbashkët i të drejtave të votës;

3.4 Të tjera konsiderata lidhur me kontrollin e përbashkët;

III. Ndryshime në cilësinë e kontrollit;

1. Hyrja e aksionarëve kontrollues;

2. Zvogëlimi i numrit të aksionarëve;

IV. Sipërmarrjet e përbashkëta/ Joint Ventures — Koncepti i funksionimit të plotë;

1. Burime të mjaftueshme për të vepruar në mënyrë të pavarur në treg;

2. Aktivitete në bazë të një funksioni specifik për ndërmarrjet mëmë;

3. Lidhjet blerje/ shitje me ndërmarrjet mëmë;

4. Operacione mbi baza të qëndrueshme (lasting basis);

5. Ndryshime në aktivitetet e sipërmarrjeve të përbashkëta/ joint ventures;

V. Përfjashtime;

VI. Heqja dorë (Abandonimi) nga përqendrimi;

VII. Ndryshime në transaksione pas vendimit për autorizim nga Komisioni;

C. Dimensionet komunitare;

I. Kufiri i pjesës së tregut;

II. Koncepti i ndërmarrjes pjesëmarrëse në fjalë;

1. Të përgjithshme;

2. Përqendrimet;

3. Përftimi i kontrollit;

III. Të dhënat përkatëse për vendosjen e juridiksionit;

#### IV. Kufiri i pjesës së tregut;

1. Koncepti i xhiros;
2. Aktivitetet e zakonshme;
3. ‘Xhiro “neto”’;
- 3.1 Zbritja e tarifës së uljeve (sales), tatimeve dhe taksave;
- 3.2 Trajtimi i xhiros së “brendshme”;
4. Llogaritja e xhiros dhe llogaritë financiare;
- 4.1 Rregulli i përgjithshëm;
- 4.2 Rregullimet pas datës së auditimit të fundit të llogarive;
5. Kufiri i Xhiros sipas nenit 16;
- 5.1 Identifikimi i ndërmarrjeve në të cilat është marrë parasysh kufiri i xhiros;
- 5.2 Shpërndarja e xhiros së ndërmarrjeve pjesëmarrëse/ të identifikuara;
- 5.3 Shpërndarja e xhiros në rastin e fondeve të investimit;
- 5.4 Shpërndarja e xhiros për ndërmarrjet e zotëruara nga shteti;

#### V. Shpërndarja gjeografike e xhiros;

#### VI. Shndërrimi i xhiros në euro;

#### VII. Dispozitat për institucionet e kreditit, institucione të tjera dhe ndërmarrjet e sigurimit;

1. Qëllimi i zbatimit;
2. Llogaritja e xhiros;
- 2.1 Llogaritja e xhiros së institucioneve të kreditit dhe institucioneve financiare (të tjera këto nga ato të institucioneve financiare (financial holding));
- 2.1.1 Të përgjithshme;
- 2.1.2 Xhiro e institucioneve financiare;
- 2.2 Ndërmarrjet e sigurimeve;
- 2.3 Ndërmarrjet financiare (Financial holding companies).

### A. **HYRJE**

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është parashikimi i rregullave që duhen zbatuar në vlerësimin dhe shqyrtimin e njoftimeve të përqendrimeve në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” (këtu e më poshtë “ligji”) si dhe të kuadrit nënligjor të Autoritetit të Konkurrencës (këtu e më poshtë “Autoriteti”) për përqendrimet. Ky udhëzim duhet ti mundësojë ndërmarrjeve që të krijohen më me shpejtësi, pavarësisht kontakteve me Autoritetin, si dhe deri në çfarë shkalle veprimtaria e tyre mund të mbulohen nga kontrolli i përqendrimeve parashikuar nga kuadri ligjor në fuqi.
2. Në këtë udhëzim parashikohen dispozita lidhur me konceptin e përqendrimeve, me konceptin e bashkimeve të shoqërive dhe me krijimin e ndërmarrjeve të përbashkëta me funksione të plota (full function joint ventures), me konceptin e ndërmarrjeve të përfshira dhe mbi llogaritjen e xhiros.
3. Rregullorja e Autoritetit “Për zbatimin e procedurave të kontrollit të përqendrimeve” zbatohet për ato transaksione që plotësojnë dy kushte. *Së pari*, duhet të ketë një përqendrim të dy ose më shumë ndërmarrjeve sipas kuptimit të nenit 10 të ligjit; *Së dyti*,

xhiro e ndërmarrjeve në fjalë, e llogaritur në përputhje me nenin 15, duhet të plotësojë kushtet e kufirit të xhiros si përcaktuar në nenin 12.1 .

## **B. Koncepti i përqendrimit**

4. Në përputhje me dispozitat ligjore, një përqendrim ndodh atëherë kur ka një ndryshim kontrolli në ndërmarrjen përkatëse dhe ky ndryshim ndodh mbi baza të qëndrueshme (lasting basis). Koncepti i përqendrimit lidhet me transaksionet, të cilat sjellin një ndryshim mbi baza të qëndrueshme në strukturën e tregut.
5. Ligji në nenin 10 të tij parashikon këto kategori të përqendrimeve:
  - a) ato që krijohen nga bashkimi ndërmjet ndërmarrjeve të pavarura më parë;
  - b) ato që krijohen nga përftimi/ ndryshimi i kontrollit.

## **I. Përqendrimet ndërmjet bashkimit të dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra tjetra**

6. Një përqendrim ndodh kur dy ose më shumë ndërmarrje, ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra tjetra, bashkohen (shkrihen së bashku) në një ndërmarrje të re dhe pushojnë së ushtruarit aktivitet si njësi të ndara ligjore. Një përqendrim mundet gjithashtu të ndodhë kur një ndërmarrje është përthithur nga një tjetër, ku kjo e fundit mban identitetin ligjor ndërsa e para pushon së ekzistuarit si një njësi ligjore.
7. Një përqendrim mundet gjithashtu të ndodhë, në rastet kur në mungesë të një përqendrimi ligjor, kombinimi i aktiviteteve të ndërmarrjeve të pavarura më parë, çon në krijimin e një njësie ekonomike të vetme. Kjo mund të ndodhë kur dy ose më shumë ndërmarrje, ndërsa ruajnë personalitetet e tyre individuale ligjore, themelojnë nëpërmjet kontratës një manaxhim të përbashkët ekonomik, ose strukturën e një shoqërie të listuar si dyshe. Nëse kjo çon në një bashkim *de facto* të ndërmarrjeve në fjalë, në një njësi të vetme ekonomike, transaksioni konsiderohet si një përqendrim. Një kërkesë për përcaktimin e një përqendrimit të tillë *de facto është ekzistenca e një menaxhimi të përhershëm dhe të vetëm ekonomik*. Faktorë të tjerë të rëndësishëm janë përftimet e brendshme dhe kompensimet nga humbjet ose një shpërndarje e të ardhurave si ndërmjet njësisve të ndryshme brenda grupit, edhe përgjegjshmërisë së tyre të përbashkët ose ndarje të riskut të jashtëm. Bashkimi *de facto* mundet vetëm të bazohet mbi marrëveshje kontraktuale, por mundet gjithashtu vetëm të ri-forcohet nëpërmjet aksioneve të ndërthurura (*cross-shareholdings*) ndërmjet ndërmarrjeve që formojnë njësinë ekonomike.

## **II. Përftimi i Kontrollit**

### **1. Koncepti i kontrollit**

#### *1.1. Personi ose ndërmarrja që përftojnë kontrollin*

8. Neni 10 parashikon se një përqendrim ndodh edhe në rastin kur kemi një përfitim kontrolli. Një kontroll i tillë mund të përftohet nga një ndërmarrje që vepron e vetme ose nga disa ndërmarrje të cilat veprojnë bashkërisht.

#### Personi i cili kontrollon një ndërmarrje tjetër

9. Kontrolli gjithashtu mund të përftohet nga një person në rrethanat ku ky person tashmë kontrollon (ose veçmas ose bashkërisht) të paktën një ndërmarrje tjetër ose ndryshe, nga një kombinim i personave (të cilët kontrollojnë një ndërmarrje tjetër) dhe ndërmarrjeve. Termi 'persona' në këtë kontekst shtrihet tek organet publike dhe njësitë private, ashtu si dhe personat ligjorë/fizikë. Përfitimet e kontrollit nga personat fizikë, konsiderohen se sjellin një ndryshim të qëndrueshëm në strukturën e ndërmarrjes në fjalë, vetëm nëse këto persona fizikë ndërmarrin aktivitete të mëtejshme ekonomike për llogari të tyre ose nëse ato kontrollojnë të paktën një ndërmarrje tjetër.

#### Përfutuesi i kontrollit

10. Kontrolli zakonisht përftohet nga persona ose ndërmarrje të cilët janë mbajtës të të drejtave ose u janë caktuar të drejta duke iu dhënë kontrollin sipas një kontrate përkatëse. Megjithatë, ka situata ku mbajtësi formal i interesave kontrolluese, ndryshon nga personi ose ndërmarrja që ka në fakt fuqinë reale për të ushtruar të drejtat që rezultojnë nga ky interes. Ky mund të jetë rasti kur p.sh, një ndërmarrje përdor një person ose ndërmarrje tjetër për përfitim të kontrollit dhe ka fuqinë që të ushtrojë të drejtat lidhur me kontrollin nëpërmjet këtij personi ose ndërmarrjeje, d.m.th ky i fundit është formalisht mbajtësi i të drejtave, por vepron vetëm si një mjet. Në këtë situatë, kontrolli përftohet nga ndërmarrja e cila në realitet është mbrapa transaksioneve dhe në fakt ka fuqinë të kontrollojë ndërmarrjen në fjalë. Kontrolli që kanë ndërmarrjet tregtare, mund ti atribuohet aksionarëve të tyre ekskluzivë, aksionarëve të tyre kryesorë ose atyre që kontrollojnë bashkërisht shoqëritë përderisa këto kompani pajtohen në çdo rast me vendimet e këtyre aksionarëve. Një pjesëmarrje aksionere kontrolluese e cila zotërohet nga subjekte të ndryshme që i përkasin një grupi, zakonisht i atribuohet ndërmarrjes që ushtron kontrollin mbi titullarë formal të të drejtave. Në raste të tjera, të dhënat që nevojiten për të krijuar këtë lloj të kontrollit indirekt, mund të merren në konsideratë të ndara ose së bashku dhe vlerësohen rast pas rasti edhe faktorë të tillë si mbajtësit e aksioneve, lidhjet kontraktuale, burimet e financimit ose lidhjet familjare etj.

#### Përfitimi i kontrollit nga fondet e investimit

11. Në rastet e përfitimit të kontrollit nga fondet e investimit, Autoriteti do të analizojë strukturat që përfshijnë fondet e investimit rast pas rasti. Fondet e investimit shpesh vendosen në formën ligjore të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, në të cilën investitorët marrin pjesë si ortakë me përgjegjësi të kufizuar dhe normalisht nuk ushtrojnë kontroll, as individualisht as kolektivisht. Këto fonde investimi, zakonisht përftojnë aksionet dhe të drejtat e votës, të cilat u japin të drejtën e kontrollit mbi portofolin e shoqërive. Në varësi të rrethanave, kontrolli zakonisht ushtrohet nga një kompani investitore, e cila ka krijuar fondin, duke qenë se fondi vetë është zakonisht një mjet investimi. Në raste të

jashtëzakonshme, kontrolli mund të ushtrohet nga vetë fondi. Kompania e investimit, zakonisht ushtron kontrollin nëpërmjet strukturës organizative, p.sh nëpërmjet kontrollit të ortakut me përgjegjësi të pakufizuar të një fondi investimi, ose nëpërmjet marrëveshjeve kontraktuale, të tilla si marrëveshje këshillimore, ose nëpërmjet një kombinimi të të dyjave. Ky mund të jetë rasti edhe kur vetë kompania e investimit nuk zotëron kompaninë që vepron si një ortak me përgjegjësi të pakufizuar por aksionet e tyre zotërohen nga persona fizikë (të cilët mund të lidhen me kompaninë investuese) ose nga një trust. Marrëveshjet kontraktuale me kompaninë e investimeve, në veçanti marrëveshjet e këshillimit, do të bëhen edhe më të rëndësishme, nëse partneri i përgjithshëm nuk ka burime të veta dhe personel për administrimin e kompanive që kanë portofolin, por përbëjnë vetëm strukturën e kompanive, veprimet e të cilave kryhen nga persona të lidhur me kompaninë investuese. Në këto rrethana, kompania investuese normalisht përfton kontroll indirekt sipas kuptimit të nenit 10 të ligjit, dhe ka fuqinë që të ushtrojë të drejtat të cilat janë direkt të zotëruara nga fondi i investimit.

## 1.2. *Mënyrat e kontrollit*

12. Kontrolli përkufizohet sipas nenit 10 të ligjit si një mundësi për të ushtruar influencë vendimtare mbi një ndërmarrje. Në këtë mënyrë nuk është e nevojshme të tregohet se influenca vendimtare ushtrohet ose do të ushtrohet aktualisht. Megjithatë, mundësia për të ushtruar këtë influencë duhet të jetë efektive. Mundësia për të ushtruar influencë vendimtare mbi një ndërmarrje mund të ekzistojë mbi bazën e të drejtave, kontratave ose mjeteve të tjera, veçmas ose në kombinim dhe duke pasur parasysh faktet. Një përqendrim i cili mundet gjithashtu të ndodhë mbi baza ligjore ose *de facto*, mund të marrë formën e kontrollit të vetëm ose të përbashkët dhe të shtrihet mbi të gjithë ose në një pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve.

### Kontrulli nga përftimi i aksioneve apo asetëve

13. Nëse nga një transaksion krijohet një përfitim kontrolli ose jo, kjo varet nga një numër elementësh ligjorë dhe/ose faktikë. Mjeti më i zakonshëm i përfimit të kontrollit është përftimi i aksioneve, mundësisht kombinuar me marrëveshjen e aksionerëve në rastet e kontrollit të përbashkët, ose përfimit të asetëve.

### Kontrulli mbi baza kontraktuale

14. Kontrolli mundet gjithashtu të përftohet mbi baza kontraktuale. Me synimin për të marrë kontrollin, kontrata në këtë rast duhet të ketë për qëllim krijimin e kontrollit të menaxhimit dhe burimeve të ndërmarrjes tjetër si në rastin e përfimit të aksioneve apo asetëve. Në të kundërt të transferimit të kontrollit mbi menaxhimin dhe burimet, kontrata të tilla duhet të karakterizohen nga një kohëzgjatje shumë e gjatë. Vetëm kontrata të tilla mund të rezultojnë në një ndryshim strukturor në treg. Shembuj të kontratave të tilla, janë kontratat organizative sipas ligjeve të shoqërive tregtare por që nuk janë të përhapura ose lloje të tjera kontratash p.sh në formën e marrëveshjeve të huadhënies së bizneseve, duke i dhënë kontrollin përfituesit mbi menaxhimin dhe burimet pavarësisht faktit që të drejtat e

pronës ose aksionet nuk transferohen. Këto janë shembuj ku kontrolli mundet të krijohet si një e drejtë për të përdorur asetet e një ndërmarrjeje. Kontrata të tilla mund të çojnë në një situatë të kontrollit të përbashkët, nëse si zotëruesi i aseteve ashtu edhe ndërmarrja që kontrollon menaxhimin, gëzon të drejtat e vetos mbi vendimet strategjike të biznesit.

#### Kontrolli nëpërmjet mënyrave të tjera

- 15.** Marrëveshjet *franchising/ të ekskluzivitetit* normalisht nuk çojnë në kontrollin mbi biznesin franchisee/ ekskluziv të francindhënësit/ të dhënësit të ekskluzivitetit. Franchin-marrësi/ Marrësi i ekskluzivitetit zakonisht shfrytëzon burimet e ndërmarrjes për llogari të tij edhe kur pjesë të rëndësishme të aseteve i takojnë francindhënësit/ dhënësit të ekskluzivitetit. Për më tepër, marrëveshjet e pastra financiare, të tilla si transaksionet e shitjes së një objekti ku më pas e jep me qera për të ri-blerë asetet në fund të afatit, normalisht nuk përbëjnë një përqendrim, duke qenë se ato nuk ndryshojnë kontrollin mbi menaxhimin dhe burimet.
- 16.** Kontrolli mund të krijohet edhe nëpërmjet mjeteve të tjera. Lidhjet ekonomike mund të luajnë një rol vendimtar për përfitim të kontrollit. Në raste të veçanta, situata e varësisë ekonomike mund të çojë në një kontroll mbi baza *de facto*, ku p.sh, luajnë influencë vendimtare marrëveshjet shumë të rëndësishme afatgjata, të ofruar nga furnizuesit ose klientët, të lidhur me rrjete strukturore. Në këtë rast duhet të analizohet me vëmendje nëse lidhje të tilla ekonomike, të kombinuara me lidhje të tjera, janë të mjaftueshëm për të çuar në një ndryshim kontrolli mbi baza të qëndrueshme.
- 17.** Mund të këtë një përfitim kontrolli edhe nëse nuk ka një qëllim të deklaruar të palëve ose nëse përfutuesi është vetëm pasiv dhe përfitimi i kontrollit ndodh nga veprimi i palëve të treta. Shembuj janë rastet ku ndryshimi i kontrollit vjen nga trashëgimitë e aksionarëve ose ku largimi i aksionarëve çon në një ndryshim kontrolli, në veçanti një ndryshim nga një kontroll i përbashkët në një kontroll të vetëm.

#### Kontrolli dhe ligji mbi shoqëritë

- 18.** Kuadri ligjor mund të parashikojë rregulla specifike mbi strukturën e organeve që përfaqësojnë vendimmarrjen brenda ndërmarrjes. Ndërsa një legjislacion i tillë mund ti japë disa fuqi kontrolluese personave të tjerë që nuk janë aksionarë, në veçanti përfaqësuesve të punonjësve, mundësia për të aplikuar këtë mënyrë për formimin e vendimeve nuk hyn në konceptin e kontrollit në kuptim të Ligjit, duke qenë se kuadri ligjor mbi përqendrimet fokusohet mbi influencën vendimtare që zotërohet mbi bazën e të drejtave, aseteve ose kontratave apo mjeteve të tjera ekuivalente *de facto*. Kufizimet të parashikuara nga statuti i shoqërisë ose dispozita të tjera që iu përkasin personave të cilët mund të bëhen anëtarë të bordit, të tilla si dispozita që kërkojnë mbledhjen e anëtarëve të pavarur ose që parashikojnë emërimin e anëtarëve të pavarur ose që përjashtojnë emërimin e personave që zhvillojnë funksione për shoqërinë mëmë ose që janë nëpunës, nuk përjashtojnë ekzistencën e kontrollit, për aq kohë sa aksionarët vendosin përbërjen e

organeve vendimmarrëse. Në mënyrë të ngjashme, pavarësisht dispozitave të ligjit që parashikojnë se vendimet e kompanive duhet të merren nga organet e veta të kompanisë në interes të tyre, këta persona që kanë të drejtat e votës, kanë fuqinë që të adoptojnë këto vendime dhe kështu kanë mundësinë që të ushtrojnë influencë vendimtare mbi ndërmarrjen.

- 19.** Interpretimi që i bëhet termit të “kontrollit” në ligje të tjera nuk është i njëjtë me konceptin e kontrollit sipas kuadrit ligjor mbi përqendrimet në fushën e konkurrencës.

### **1.3. Objekti i kontrollit**

- 20.** Objekt i kontrollit mund të jenë një ose më shumë, ose gjithashtu pjesë të ndërmarrjeve të cilat përbëjnë njësinë ligjore, ose asetëve të kësaj njësie ose vetëm një pjesë e këtyre asetëve. Përftimi i kontrollit mbi asetet mund të konsiderohet si një përqendrim, vetëm nëse këto asete përbëjnë ndërmarrjen si një e tërë ose një pjesë të saj d.m.th një biznes me një përfaqësim në treg, e cila ka një xhiro vjetore tregu. Transferimi i klientelës të një biznesi mund të plotësojë këto kritere nëse kjo është e mjaftueshme për të transferuar një biznes me një xhiro në treg. Një transaksion në lidhje me asetet e pa-prekshme të tilla si markat, patentat ose të drejtën e autorit mund të konsiderohet si një përqendrim nëse këto asete përbëjnë një biznes me një xhiro vjetore. Në çdo rast, transfertat e licencave të markës, patentave ose të të drejtave të autorit, pa asete të tjera shtesë, mundet vetëm të plotësojë këto kritere nëse licencat janë ekskluzive në të paktën një territor të caktuar dhe transfertat e këtyre licencave do të transferojnë aktivitetin që gjeneron xhiroja. Nga licencat jo ekskluzive mund të përjashtohen ato që mund të përbëjnë një biznes më vete, të cilat gjenerojnë xhiro në treg.
- 21.** Ka raste kur një ndërmarrje iu jep të tretëve aktivitete të brendshme, të tilla si dhënien e shërbimeve ose prodhimin e produkteve të një ofrues shërbimesh (outsourcing). Raste tipike janë outsourcing të shërbimeve të teknologjisë së informacionit/ IT të kompani të specializuara IT. Kontratat për outsourcing mund të marrin forma të ndryshme; karakteristikë e zakonshme e tyre është që ofruesi i outsourcing duhet ti sigurojë këto shërbime klientëve, ku këta të fundit kanë punuar si të brendshëm më parë. Raste të outsourcing nuk përfshijnë ndonjë transfertë të asetëve apo punonjësve tek ofruesi i shërbimeve të jashtme, por zakonisht është rasti që çdo aset ose nëpunës mbahet nga klienti. Një kontratë e tillë është e ngjashme me një kontratë normale shërbimesh dhe edhe nëse ofruesi i shërbimeve outsourcing përftojnë të drejtën për të drejtuar këto asete dhe nëpunësit e klientëve, nuk ka përqendrim nëse asetet dhe nëpunësit përdoren ekskluzivisht për shërbimet e klientëve.
- 22.** Situata mund të jetë e ndryshme nëse ofruesi i outsourcing, duke kryer aktivitete të caktuara të cilat më parë ishin siguruar nga brenda ndërmarrjes, ka transferuar asetet e dhe personelin përkatës. Një përqendrim mund të ndodhë në këto rrethana, nëse asetet përbëjnë të gjithë ose një pjesë të ndërmarrjes, d.m.th një biznes i cili është aktiv në treg. Kjo kërkon që asetet e mëparshme, të dedikuara për aktivitetet e brendshme të shitësit do t'u mundësojnë ofruesve të shërbimeve outsourcing që të ofrojnë shërbime jo vetëm për

klientët e jashtëm, por gjithashtu edhe për palët e treta, ose menjëherë ose brenda një periudhe të shkurtër pas transfertës. Ky është rasti kur transfertat lidhet me një njësi të biznesit të brendshëm ose një degë tashmë të lidhur me parashikimin e shërbimeve për palët e treta. Nëse palëve të treta nuk iu është ofruar ende shërbimi, asetet e transferuara në rastin e prodhimit duhet të përmbajnë lehtësi në prodhim, produkte know-how (është e mjaftueshme nëse asetet e transferuara lejojnë ndërtimin e këtyre kapaciteteve në të ardhmen e afërt) dhe duhet të sigurojë mjetet për blerësin për të lejuar hyrjen në treg brenda një periudhe të shkurtër, nëse ky i fundit nuk ka aktivitet në tregun ekzistues (përfshirë kontratat ekzistuese ose markat). Përsa i takon dispozitave mbi shërbimet, asetet e transferuara duhet të përfshijnë know-how/ njohuritë e kërkuara (p.sh personeli përkatës dhe të drejtat e pronësisë intelektuale) dhe ato lehtësi për të cilat i lejon aksesin në treg (të tilla si lehtësirat në marketing). Asetet e transferuara duhet të përfshijnë të paktën ato elementë që i lejojnë një përftuesi që të shfaqë prezencën në treg në një kohë të ngjashme me periudhën e fillimit për sipërmarrje të përbashkët/ joint ventures ashtu siç është përcaktuar më poshtë në paragrafët 81, 84. Si në rastin e sipërmarrjeve të përbashkëta/ joint ventures, Autoriteti do të marrë në konsideratë planet kryesore të biznesit dhe të treguesve të përgjithshëm të tregut për vlerësimin e tij.

23. Nëse asetet e transferuara nuk e lejojnë blerësin që të paktën të zhvillojë prezencën në treg, është e mundur që kjo të përdoret vetëm për të ofruar shërbime outsourcing për klientët. Në këto rrethana, transaksioni nuk do të rezultojë në një ndryshim të qëndrueshëm të strukturës së tregut dhe kontratat e jashtme janë sërish të ngjashme me një kontratë shërbimesh. Transaksioni në këtë rast nuk do të përbëjë një përqendrim. Kushtet e veçanta që një sipërmarrje e përbashkët/ joint venture për shërbime outsourcing të konsiderohet si një përqendrim janë të ilustruara në seksionin përkatës për joint ventures (Joint ventures me funksione të plota).

#### 1.4. Ndryshimi i kontrollit mbi baza të qëndrueshme

24. Sipas dispozitave ligjore, koncepti i përqendrimeve lidhet vetëm me ato transaksione të cilat sjellin një ndryshim të qëndrueshëm në kontrollin e ndërmarrjeve në fjalë, dhe në strukturën e tregut. Në këtë grup nuk përfshihen transaksionet të cilat rezultojnë vetëm në një ndryshim të përkohshëm të kontrollit. Megjithatë, një ndryshim i kontrollit mbi baza të qëndrueshme nuk përjashtohet nga fakti se marrëveshjet në fjalë kanë hyrë në fuqi për një kohë të përcaktuar, duke siguruar që këto marrëveshje janë të përsëritshme/ rinovueshme (*renewable*). Do të kemi një përqendrim edhe në rastet kur marrëveshja parashikon një datë përfundimi, nëse periudha është mjaftueshmërisht e gjatë për të çuar në një ndryshim të qëndrueshëm të kontrollit të ndërmarrjes në fjalë.
25. Nëse një operacion rezulton në një ndryshim të qëndrueshëm të strukturës së tregut është gjithashtu e përshtatshme për vlerësimin e disa operacioneve që ndodhin në seri, ku transaksioni i parë është vetëm me natyrë tranzitore. Dallohen disa skenarë të këtij rasti:



26. *Skenari i parë* do të ishte rasti ku disa ndërmarrje bashkohen vetëm për qëllime të përfuturit të një shoqërie tjetër mbi baza të një marrëveshjeje, për të ndarë asetet e përfuturara të një plani para-ekzistues menjëherë pas përfuturit të transaksionit. Në këto rrethana, në një hap të parë, përfuturi i të gjithë shoqërisë është ndërmarrë nga një ose disa ndërmarrje. Në hapin e dytë, asetet e përfuturara janë ndarë midis disa ndërmarrjeve. Pyetja është nëse transaksioni i parë konsiderohet si një përqendrim i ndarë që përfshin një përfutim të kontrollit të vetëm (në rastin e një blerësi të vetëm) ose të një kontrolli të përbashkët (në rastin e një blerëje të përbashkët) të të gjithë ndërmarrjes, ose nëse vetëm përfuturi i hapit të dytë përbën përqendrim, ku secila nga ndërmarrjet përfutuese përfuton pjesën e saj përkatëse në ndërmarrjen në fjalë.
27. Në këtë rast transaksionet e para konsiderohen se nuk përbëjnë një përqendrim dhe shqyrtohet përfuturi i kontrollit nga përfutuesit e fundit, duke siguruar se një numër kushtesh janë përmbushur: *Së pari*, ndarja e mëpasshme duhet të jetë rënë dakord ndërmjet blerësve të ndryshëm në një mënyrë ligjore bindëse. *Së dyti*, nuk duhet të ketë ndonjë pasiguri që hapi i dytë, ndarja e aseteve të përfuturara, do të ndodhë në një periudhë të shkurtër pas përfuturit të parë. Maksimumi i kohës për ndarjen e aseteve duhet të jetë deri një vit. Nëse plotësohen të dy kushtet, përfuturi i parë nuk rezulton me ndryshime strukturore mbi baza të qëndrueshme. Nuk ka përqendrim efektiv të fuqisë ekonomike ndërmjet përfutuesve dhe kompanive në fjalë si një e tërë për sa kohë asetet e përfuturara nuk mbahen në një formë individuale mbi baza të qëndrueshme, por vetëm për aq kohë që është e mjaftueshme për të ndërmarrë ndarje të menjëhershme të aseteve të përfuturara. Në këto rrethana, vetëm përfuturi i pjesëve të ndryshme të ndërmarrjes në hapin e dytë do të përbëjë përqendrim, me anë të së cilës secili nga këto përfutime prej blerësve të ndryshëm do të përbëjë një përqendrim të ndarë. Kjo ndodh pavarësisht nëse përfuturi i parë është ndërmarrë ndaj vetëm një ndërmarrje ose bashkërisht nga ndërmarrjet të cilat janë gjithashtu të përfshira në hapin e dytë. Në çdo rast, duhet të kihet parasysh që vendimi i autorizimit do të lejojë përfutimin e të tërë ndërmarrjes, nëse ndarja mund të vazhdojë brenda një periudhe të shkurtër kohore më pas dhe pjesët e ndryshme të ndërmarrjes në fjalë i shiten direkt blerësit respektiv të fundit.
28. Megjithatë, nëse këto kushte nuk plotësohen, në veçanti nëse nuk është e sigurt se hapi i dytë do të ndodhë brenda një kohe të shkurtër pas përfuturit të parë, transaksioni i parë konsiderohet si një përqendrim i ndarë, që përfshin të gjithë ndërmarrjen në fjalë. Ky është rasti kur transaksioni i parë mundet gjithashtu të ndodhë në mënyrë të pavarur nga transaksioni i dytë ose nëse periudha më e gjatë e tranzicionit është nevojshme të ndajë ndërmarrjen në fjalë.
29. *Skenari i dytë* do të ishte rasti kur një operacion i cili çon në një kontroll të përbashkët për një periudhë që fillon me marrëveshjet ligjore detyruese/lidhëse, ku kontrolli i përbashkët do të konvertohet në një kontroll të vetëm nga një prej aksionarëve. Duke qenë se situata e kontrollit të përbashkët, mund të mos sjellë një ndryshim të qëndrueshëm të kontrollit, operacioni i gjithi mund të konsiderohet si një përfutim i kontrollit të vetëm. Në të kaluarën, Komisioni pranonte që periudha e fillimit mund të zgjaste deri në tre vjet. Një periudhë e tillë duket sikur është tepër e gjatë për të përjashtuar rastin kur kontrolli i përbashkët ka

një ndikim në strukturën në treg. Në përgjithësi duhet që periudha të mos tejkalojë një vit dhe periudha e kontrollit të përbashkët të jetë transitore në natyrë. Vetëm një periudhë e tillë relativisht e vogël e bën të pamundur që periudha e kontrollit të përbashkët të ketë një ndikim të ndryshëm mbi strukturën e tregut dhe si e tillë të konsiderohet se nuk çon në një ndryshim kontrolli mbi baza të qëndrueshme.

- 30.** *Rasti i skenarit të tretë*, është kur një ndërmarrje është “parkuar” me një blerës të brendshëm zakonisht një bankë, mbi baza të një marrëveshjeje mbi shitjet e ardhshme të biznesit tek një përftues përfundimtar. Blerësi i ndërmjetëm zakonisht përfton pjesë për llogari të përftuesit fundor, i cili zakonisht mban pjesën kryesore të riskut ekonomik dhe që gjithashtu mund ti jepet të drejta të veçanta. Në këto rrethana, transaksioni i parë është ndërmarrje vetëm për të lehtësuar transaksionin e dytë dhe blerësi i parë është direkt i lidhur me përftuesit fundor. Në të kundërt të situatës të përshkruar në skenarin e parë më lart, asnjë përftues tjetër fundor nuk është përfshirë; biznesi i caktuar mbetet i pandryshueshëm dhe vijimi i transaksionit është iniciuar vetëm nga një përftues fundor. Autoriteti shqyrton përftimin e kontrollit nga një përftues fundor, ashtu siç parashikohet në marrëveshjen e lidhur midis palëve dhe do të merret në konsideratë transaksioni nga i cili një blerës i ndërmjetëm përfton kontrollin mbi të tilla rrethana si një hap të parë të një përqendrimi të vetëm që përbën përftimin e qëndrueshëm të kontrollit nga blerësi fundor.

#### **1.5. Transaksionet e ndërlidhura**

##### **1.5.1. Lidhjet ndërmjet nenit 10 dhe nenit 15**

- 31.** Disa transaksione mund të trajtohen si një përqendrim i vetëm. Neni 10 përcakton ekzistencën e “përqendrimit” në terma të përgjithshëm dhe neni 15, 16, dhe 17 ka për qëllim që të specifikojë xhiron që duhet të merret në konsideratë për qëllime të përcaktimit nëse një përqendrim duhet të njoftohet apo jo. Për qëllimin e llogaritjes së xhiros, Autoriteti duhet të analizojë nëse dy ose më shumë transaksione përqendrimesh përbëjnë një përqendrim të vetëm.

##### **1.5.2. Transaksionet e ndërvarura**

- 32.** Përcaktimi i përgjithshëm dhe teorik i një përqendrimi sipas nenit 10 (rezultatet kontrollohen nga një ose më shumë ndërmarrje) nënkupton se nuk ka ndryshim nëse kontrolli është përftuar nga një ose më shumë transaksione ligjore, duke siguruar se rezultati përfundimtar përbën një përqendrim të vetëm. Dy ose më shumë transaksione përbëjnë një përqendrim të vetëm, nëse ato janë unike në natyrë. Për këtë arsye duhet të përcaktohet nëse rezultati çon në dhënien direkt ose indirekt tek një ose më shumë ndërmarrje të kontrollit ekonomik mbi aktivitetet e një ose më shumë ndërmarrje/sh. Për vlerësimin e kësaj situatë, duhet të identifikohet realiteti ekonomik i cili është pas këtij transaksioni si dhe qëllimi ekonomik që kanë ndjekur palët. Më fjalë të tjera, me qëllim që të përcaktohet natyra unike e transaksionit në fjalë, është e nevojshme, në secilin rast individual, që të sigurohemi nëse këto transaksione janë të ndërvarura, në mënyrë të tillë që një transaksion nuk do të ishte kryer pa tjetrin.

33. Është e përshtatshme që të trajtohen si një transaksion i vetëm, ato transaksione që janë të lidhura ngushtë. Kriteri që përcakton nëse transaksioni është i ndërvarur kërkon që transaksionet të jenë të lidhura me kusht.
34. Ky model reflekton, nga njëra anë, transaksionet në lidhje me objektivat ekonomike të kryera nga palët duhet të analizohen në një procedurë. Në këto rrethana, ndryshimi i strukturës së tregut ka ardhur si pasojë e këtyre transaksioneve së bashku. Nga ana tjetër, nëse transaksionet e ndryshme nuk janë të ndërvarura dhe nëse palët do të realizojnë një nga këto transaksione, edhe pse transaksionet e tjerë nuk do të ishin të suksesshëm, është e përshtatshme që këto transaksione të vlerësohen individualisht.
35. Megjithatë disa transaksione, edhe pse janë të lidhura me kusht me njëra tjetrën, mund të trajtohen si një përqendrim i vetëm, nëse kontrolli është përfunduar së fundmi nga e njëjta/të njëjtat ndërmarrje. Vetëm në këto rrethana, dy ose më shumë transaksione mund të konsiderohen si unike në natyrë dhe si rrjedhim të përbëjnë një përqendrim të vetëm. Kjo përjashton shpërbërjen e e joint ventures nga të cilat pjesë të ndryshme të ndërmarrjes janë ndarë ndërmjet kompanive mëmë të mëparshme. Këto transaksione konsiderohen si përqendrime të ndara. E njëjta praktikë zbatohet për transaksionet ku dy ose më shumë kompani shkëmbejnë asete në transaksionet që përfshijnë përqendrimet e joint ventures ose asetet e shkëmbyera. Pavarësisht se palët do të konsiderojnë këto transaksione si të ndërvarura, kërkohet një vlerësim i ndarë i rezultateve të secilit transaksion: Disa ndërmarrje përftojnë kontroll mbi asetet e ndryshme, për secilin nga ndërmarrjet përftuese do të kryhet një kombinim i ndryshëm i burimeve dhe ndikimi në treg për secilin nga këto përftime kontrolli duhet të analizohet në mënyrë të veçantë.
36. Përfitimi i shkallëve të ndryshme të kontrollit (p.sh, kontrolli i përbashkët i një biznesi dhe kontrolli i vetëm i një biznesi tjetër) shtron disa pyetje specifike. Një operacion i cili përfshin përfitim të kontrollit të përbashkët të një pjese të ndërmarrjes dhe kontrollin e vetëm të një pjese tjetër, në parim vlerësohet si dy përqendrime të ndara. Këto transaksione përbëjnë vetëm një përqendrim nëse ato janë të ndërvarura dhe nëse ndërmarrja që përfton kontrollin e vetëm, gjithashtu përfton kontrollin e përbashkët. Vlerësohet se në një rast të tillë do të kemi një përqendrim të vetëm atëherë kur përftohet një subjekt të cilit i përketin si ndërmarrja e kontrolluar në mënyrë ekskluzive (kontroll të vetëm) ashtu edhe ndërmarrja e kontrolluar në mënyrë të përbashkët. Situata kur e njëjta ndërmarrje përfton kontrollin e vetëm dhe të përbashkët të ndërmarrjeve të tjera bazuar në marrëveshjet e ndërvarura nuk duhet trajtuar në mënyrë të ndryshme. Këto transaksione, nëse ato janë të ndërvarura, përbëjnë një përqendrim të vetëm.

*Kërkesat lidhur me kushtëzimin e transaksioneve*

37. Kushtet që kërkohen janë të tilla që asnjë nga transaksionet nuk do të kryhet pa tjetrin dhe kështu ato do të përbëjnë një operacion të vetëm. Një kushtëzim i tillë normalisht demonstron nëse transaksionet lidhen *de jure* d.m.th marrëveshjet në vetvete janë të lidhura nga kushte të ndërsjella. Nëse *de facto* kushtëzimi mundet të vërtetohet, kjo është e mjaftueshme për trajtimin e transaksioneve si një përqendrim i vetëm. Kjo kërkon një

vlerësim ekonomik nëse secili nga këto transaksione varet në mënyrë të nevojshme nga përmbyllja/ përfundimi i tjetrit. Tregues të mëtejshëm mbi ndërvarësinë e disa transaksioneve mund të jenë deklaratat e vetë palëve ose përmbylljet e menjëhershme të marrëveshjeve përkatëse. Një përmbyllje *de facto* ndër-kushtëzues i disa transaksioneve do të jetë i vështirë për tu arritur nëse nuk janë të njëkohshme. Ndërvarësia e vërtetë e transaksioneve ligjore të ndër-kushtëzuara mundet të vihet në dyshim nëse nuk janë të njëkohshme.

- 38.** Parimi se disa transaksione mund të trajtohen si një përqendrim i vetëm zbatohet vetëm nëse rezultati, është që kontrolli i një ose më shumë ndërmarrjeve përfitohet nga i njëjti person ose ndërmarrje. *Së pari* ky mund të jetë rasti ku një biznes i vetëm ose ndërmarrje është përftuar nëpërmjet disa transaksioneve ligjore. *Së dyti*, gjithashtu përftimi i kontrollit nga disa ndërmarrje-të cilat mund të përbëjnë përqendrime të ndara -mund të lidhen në mënyrë të tillë që të përbëjnë një përqendrim të vetëm. Megjithatë, nuk është e mundur që të lidhen transaksione të ndryshme ligjore, të cilat vetëm pjesërisht i takojnë përftimit të kontrollit të ndërmarrjeve, por gjithashtu pjesërisht edhe përftimin e asetëve të tjera, të tilla si paketa e aksioneve në minorancë jo kontrolluese. Nuk do të jetë në linjë me kuadrin e përgjithshëm nëse transaksione të ndryshme, të kushtëzuara ndërmjet tyre, do të vlerësoheshin si një e tërë, kur vetëm disa nga këto transaksione çojnë në një ndryshim të kontrollit të një grupi të caktuar.

#### *Përftimi i biznesit të vetëm*

- 39.** Një përqendrim i vetëm mundet të ekzistojë nëse i njëjti blerës përfton kontrollin e një biznesi të vetëm, d.m.th një entitet ekonomik i vetëm, nëpërmjet disa transaksioneve ligjore, nëse këto janë të ndër-kushtëzuara. Ky është rasti kur pavarësisht nëse biznesi është përftuar në një strukturë korporate, që përbën një ose disa kompani, ose nëse asete të ndryshme janë përftuar dhe formojnë një biznes të vetëm d.m.th një entitet ekonomik të vetëm që menaxhohet për qëllime tregtare, tek i cili kontribuojnë të gjitha asetet. Një biznes i tillë mund të përfshijë aksionet mazhoritare ose në minorancë të kompanisë si dhe të gjitha asetet e trupëzuara dhe të patrupëzuara. Nëse disa transaksione ligjore të cilat janë të ndërvarura, kërkohen që të transferojnë një biznes të tillë, këto transaksione përbëjnë një përqendrim.

#### *Përftimet paralele dhe në seri të kontrollit*

- 40.** Për trajtimin e disa përftimeve të kontrollit si një përqendrim të vetëm, mund të dallohen disa raste. Rasti i parë është përftimi paralel i kontrollit, d.m.th ndërmarrja A përfton kontrollin e ndërmarrjes B dhe C paralelisht nga shitësi të veçantë me kushtin që A nuk është i detyruar që të blejë dhe as shitësi është i detyruar që të shesë, më përjashtim të rastit kur të dy transaksionet përmbyllen. Një skenar tjetër është përftimi në seri i kontrollit, d.m.th ndërmarrja A përfton kontrollin e ndërmarrjes B i kushtëzuar nga përftimi më parë ose i njëkohshëm nga B i ndërmarrjes C.

#### *Përftimi në seri i kontrollit të vetëm/të përbashkët*

**41.** Autoriteti shqyrton rastet kur, në një seri transaksionesh, një ndërmarrje bie dakord që të përftojë së pari kontrollin e vetëm mbi një ndërmarrje të caktuar me këndvështrimin që ti shesë një ndërmarrjeje tjetër pjesëmarrjen e përftuar në ndërmarrjen e parë, duke shkaktuar kontrollin e përbashkët të të dy përfguesve mbi të njëjtën shoqëri. Nëse të dy përftimet janë të ndër-kushtëzuara, të dy transaksionet përbëjnë një përqendrim të vetëm dhe në këtë rast do të merret në konsideratë vetëm përftimi i kontrollit të përbashkët, si rezultat përfundimtar i transaksionit.

### 1.5.3. Transaksionet seri mbi titujt e pronësisë

**42.** Një përqendrim i vetëm krijohet në rastet kur kontrolli mbi një ndërmarrje është përftuar nga një seri transaksionesh prej një ose disa shitësve mbi titujt e pronësisë që përmbillen brenda një periudhë kohore të shkurtër. Përqendrimi në këto raste nuk është i kufizuar për përfkrimin e një pjesë “të vetme dhe vendimtare” por gjithashtu mbulon të gjithë përfkrimin e titujve të pronësisë që përmbillet në një periudhë të shkurtër kohore.

### 1.5.4. Neni 15 i ligjit

**43.** Në nenin 15 parashikohet një rregull specifik sipas të cilit transaksionet vijuese që ndodhin në një periudhë të caktuar kohore konsiderohen si një përqendrim i vetëm për qëllime të llogaritjes së xhiros së ndërmarrjes pjesëmarrëse. Qëllimi i kësaj dispozite është të sigurojë se i njëjti transaksion nuk ndahet në një numër transaksionesh seri (shitjesh asetesh në seri) me qëllim që të shmangin kompetencat që i takojnë Autoritetit për vlerësimin e përqendrimeve.

**44.** Nëse dy ose më shumë transaksione (secili nga ato sjellin një përfitim kontrolli) ndodhin brenda një periudhe 2- vjeçare ndërmjet të njëjtëve persona ose ndërmarrje, ato do të kualifikohen si një përqendrim i vetëm, pavarësisht faktit nëse këto transaksione i përkasin të njëjtit aktivitet ose sektor. Kjo nuk zbatohet kur të njëjtët persona ose ndërmarrje i bashkohen personave ose ndërmarrjeve të tjera vetëm për disa nga transaksionet e përfshira. Është e mjaftueshme nëse transaksionet, edhe pse jo të ndërmarrja ndërmjet të njëjtave kompani, janë realizuar nga kompani që i përkasin të njëjtit grup përkatës. Dispozitat gjithashtu zbatohen për dy ose më shumë transaksione ndërmjet të njëjtëve persona ose ndërmarrje nëse ato janë realizuar njëkohësisht. Në rastet kur ato çojnë në një përfitim kontrolli nga e njëjta ndërmarrje, një transaksion i tillë i njëkohshëm ndërmjet të njëjtave palë formon një përqendrim të vetëm edhe nëse ato nuk janë të kushtëzuara nga njëra tjetra. Megjithatë, kjo dispozitë nuk do të zbatohet për transaksione të ndryshme nga të cilat të paktën njëri transaksion përfshin ndërmarrjen pjesëmarrëse e cila është e ndryshme nga shitësi/t dhe blerësi/t i/të përbashkët. Në situatat që përfshijnë dy transaksione ku një nga transaksionet rezulton në një kontroll të vetëm dhe tjetri në një kontroll të përbashkët, kjo dispozitë nuk zbatohet nëse të paktën njëra ose disa ndërmarrje mëma të cilat kanë kontroll të përbashkët në transaksionet e mëpasshme janë shitësit e paketës së kontrollit të vetëm në transaksionin e mëparshëm.

## 1.6. *Ristrukturimi i brendshëm*

45. Në kuptim të nenit 10 mund të ketë një përqendrim vetëm atëherë kur ndodh një ndryshim kontrolli. Një strukturim i brendshëm brenda një grupi ndërmarrjesh nuk përbën një përqendrim. Ky koncept aplikohet psh. në rastin e zmadhimit të pjesëmarrjes aksionare të cilat nuk shoqërohen me ndryshim të kontrollit, ose transaksioneve të ristrukturimit të brendshëm si psh. shkrirja e një ndërmarrjeje të listuar në bursë (strukturë ndërmarrje në të cilën dy ndërmarrje funksionojnë si një biznes i vetëm por që kanë entitete të veçanta ligjore) në një subjekt të vetëm juridik, ose shkrirja e ndërmarrjeve të kontrolluara (degëve, filialeve). Do të kishim një përqendrim vetëm nëse operacioni do të shkaktonte një ndryshim në cilësinë e kontrollit të një ndërmarrjeje, i cili si pasojë nuk do të kishte vetëm natyrë të brendshme.

#### 1.7. Përqendrimet që përfshijnë ndërmarrje që zotërohen nga shteti

46. Një situatë e veçantë ekziston kur edhe ndërmarrja përfutuese edhe ndërmarrjet që përftohen janë kompani që zotërohen nga i njëjti shtet (ose nga i njëjti ent publik ose bashki). Në këtë rast, nëse operacioni do të konsiderohet si një ristrukturim i brendshëm varet nga fakti nëse të dy ndërmarrjet më parë ishin pjesë e të njëjtës njësi ekonomike. Nëse ndërmarrjet ishin pjesë e njësisive ekonomike të ndryshme që kanë fuqi të pavarur në vendimmarrje, operacionet do të përbëjnë një përqendrim dhe jo një ristrukturim të brendshëm. Megjithatë, kur njësitë e ndryshme ekonomike do të vazhdojnë të kenë fuqi të pavarura në vendimmarrje edhe pas operacionit, operacioni do të konsiderohet si një ristrukturim i brendshëm, edhe nëse aksionet e ndërmarrjes, që përbëjnë njësi të ndryshme ekonomike, do të mbaheshin nga e njëjta njësi, si një shoqëri e pastër aksionere.

47. Megjithatë, privilegjet e ushtruara nga shteti, që vepron si një autoritet publik më tepër se sa si një aksioner, për sa kohë ato janë të kufizuara në mbrojtjen e interesit publik, nuk përbëjnë kontroll sipas kuptimit të dispozitave të ligjit deri në masën që ato nuk kanë as qëllimin dhe as efektet që ti mundësojnë shtetit të ushtrojë një influencë vendim-marrëse mbi aktivitetin e ndërmarrjes.

#### 2. Kontrolli i vetëm

48. Kontrolli i vetëm përftohet nëse një ndërmarrje e vetme mund të ushtrojë influencë vendim-marrëse mbi një ndërmarrje. Në këtë rast mund të dallojmë dy situata të përgjithshme në të cilat një ndërmarrje ka kontrollin e vetëm. *Së pari*, ndërmarrja e vetme kontrolluese ka fuqinë që të përcaktojë vendime strategjike tregtare mbi një ndërmarrje tjetër. Kjo fuqi arrihet nga përfitimi i të drejtave maxhoritare të votës në një kompani. *Së dyti*, një situatë i referohet kontrollit të vetëm kur një aksioner është në gjendje të ushtrojë të drejtën e vetos strategjike vendim-marrëse në një ndërmarrje, por ku aksioneri nuk ka fuqinë, me veton e tij, që të imponojë këto vendime (i ashtuquajtur kontrolli i vetëm negativ). Në këto rrethana, një aksionar i vetëm, ka të njëjtin nivel influence si ai që ka një aksionar individual, i cili kontrollon bashkërisht një kompani, d.m.th fuqinë për të bllokuar marrjen e vendimeve strategjike. Në të kundërt të kësaj situatë, në një kompani që ka kontrollin e përbashkët, nuk ka aksionarë të tjerë që kanë të njëjtin nivel influence

dhe aksionarë që kanë kontrollin e vetëm negativ dhe nuk nevojitet domosdoshmërisht që të bashkëpunojnë me aksionarë të tjerë të veçantë për të përcaktuar sjelljen strategjike të ndërmarrjes së kontrolluar. Përderisa ky aksionar mund të prodhojë një situatë bllokuese, aksionari përfton influencë vendim-marëse dhe si rrjedhim kontrollin.

Kontrolli i vetëm mund të përftohet mbi baza *de jure* dhe/ose *de facto*

*Kontrolli i vetëm De jure*

49. Kontrolli i vetëm normalisht përftohet mbi baza ligjore kur një ndërmarrje përfton shumicën e të drejtave të votës të një ndërmarrjeje. Në mungesë të elementëve të tjerë, një përftim i cili nuk përfshin shumicën e të drejtave të votës, normalisht nuk përbën kontroll edhe nëse përfton shumicën e kapitalit aksionar. Kur statuti i ndërmarrjes kërkon një shumicë të cilësuar për vendime strategjike, përftimi i shumicës së thjeshtë të të drejtave të votës mund të mos japë fuqinë për të përcaktuar vendime strategjike, por mund të jetë i mjaftueshëm për ti dhënë përftuesit të drejta veto-je dhe si rrjedhojë kontrollin negativ.
50. Edhe në rastin e aksionarëve të pakicës, kontrolli i vetëm mund të ndodhë mbi baza ligjore në situatat kur të drejta të veçanta janë të bashkëlidhura me këto aksione. Këto mund të jenë aksione preferenciale për të cilat të drejtat e veçanta janë të bashkëlidhura duke mundësuar aksionarët e pakicës që të përcaktojnë sjellje tregtare strategjike të ndërmarrjes në fjalë, të tilla si fuqia për të caktuar më tepër se sa gjysmën e anëtarëve të bordit mbikëqyrës ose bordit administrativ. Kontrolli i vetëm mundet gjithashtu që të ushtrohet nga aksionarët në pakicë, të cilët kanë të drejtën që të menaxhojnë aktivitetin e ndërmarrjes dhe të përcaktojnë politikat e biznesit mbi baza të një strukture organizative (p.sh. si një ortak me përgjegjësi të pakufizuar të një shoqërie komandite i cili shpesh nuk ka asnjë kuotë).
51. Një situatë tipike e kontrollit negativ ndodh kur një aksionar ka 50 % në një ndërmarrje ndërsa pjesa mbetëse prej 50 % zotërohet nga disa aksionerë të tjerë (duke supozuar se kjo nuk çon në një kontroll të vetëm pozitiv mbi baza *de facto*), ose kur ka një shumicë të cilësuar për vendime strategjike të cilat në fakt përbëjnë të drejtën e vetos mbi vetëm një aksionar, pavarësisht nëse është një aksionar në maxhorancë apo minorancë.

*Kontrolli i vetëm de facto*

52. Një aksioner në minorancë mundet gjithashtu që të ketë kontrollin e vetëm mbi baza *de facto*. Ky është rasti kur aksionari ka shumë të ngjarë që të arrijë shumicën në asamblenë e aksionerëve, duke pasur parasysh nivelin e aksioneve të tij dhe duke konsideruar sa dhe cilët aksionarë kanë qënë prezent në asambletë e viteve të fundit. Bazuar në modelin e mëparshëm të votimit, Autoriteti do të ndërmarrë një analizë dhe do të ketë parasysh ndryshimet e parashikueshme/ mundshme të prezencës së aksionarëve të cilat mund të ndodhin në të ardhmen pas transaksionit. Autoriteti analizon pozicionin e aksionerëve të tjerë dhe vlerëson rolin e tyre. Kriteret për një vlerësim të tillë janë nëse aksionet që mbeten janë gjerësisht të shpërndara, ndërsa aksionarë të tjerë të rëndësishëm kanë lidhje

strukture, ekonomike ose familjare me aksionarët e pakicës të cilët kanë pjesëmarrje të rëndësishme ose nëse aksionarë të tjerë kanë një interes të pastër strategjik apo financiar në kompaninë në fjalë. Këto kritere do të vlerësohen mbi baza rast pas rasti. Kur, mbi baza të pjesëmarrjes së aksioneve, modelit të votimit në asamblenë e aksionarëve dhe pozicionit të aksionarëve të tjerë, është e mundur që një aksionar i pakicës të ketë një shumicë të qëndrueshme të votave në asamblenë e aksionarëve, atëherë presupozohet se aksionari i pakicës ka kontrollin e vetëm.

53. Një opsion për të blerë ose shkëmbyer aksione, në vetvete nuk shkakton kontrollin e vetëm, me përjashtim të rastit kur e drejta e opsionit do të ushtrohet në të ardhmen e afërt në përputhje me marrëveshjet ligjore detyruese. Megjithatë, në rrethana të veçanta, një opsion së bashku me elementë të tjerë, mund të çojë në konkluzionin se ka një kontroll të vetëm *de facto*.

*Kontrolli i vetëm i përftuar nga mjete të tjera dhe jo nëpërmjet të drejtave të votës.*

### 3. Kontrolli i përbashkët

54. Kontrolli i përbashkët ekziston kur dy ose më shumë ndërmarrje ose persona kanë mundësinë që të ushtrojnë influencë vendimmarëse mbi ndërmarrjet e tjera. Influenca vendimmarëse nënkupton fuqinë për të bllokuar veprimet të cilat përcaktojnë sjelljen strategjike tregtare të një ndërmarrje. Në të kundërt të kontrollit të vetëm, i cili i përket një aksionari të veçantë duke i dhënë fuqinë që të përcaktojë vendime strategjike në një ndërmarrje, kontrolli i përbashkët karakterizohet nga mundësia për të bllokuar situatën që rezulton nga fuqia e dy ose më shumë ndërmarrjeve mëmë për të refuzuar vendime të propozuara strategjike. Duke vijuar më tej, këto aksionarë duhet të arrijnë një pikë të përbashkët në përcaktimin e politikave të sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture dhe që janë të detyruar të bashkëpunojnë.

55. Si në rastin e kontrollit të vetëm, përftimi i kontrollit të përbashkët mund të krijohet mbi baza *de jure* ose *de facto*. Ka kontroll të përbashkët nëse aksionarët (ndërmarrjet mëmë) iu duhet të arrijnë marrëveshje mbi vendime të rëndësishme që i përkasin ndërmarrjes së kontrolluar (sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture).

#### 3.1. Barazia në të drejtat e votës ose caktimi i organeve vendimarrëse

56. Forma më e qartë e kontrollit të përbashkët ekziston kur janë vetëm dy ndërmarrje mëmë të cilat ndajnë në mënyrë të barabartë të drejtat e votës në një sipërmarrje të përbashkët/ joint venture. Në këtë rast, nuk është e nevojshme që të ekzistojë një marrëveshje formale ndërmjet tyre. Megjithatë, kur ka një marrëveshje formale, duhet të jetë në përputhje me parimet e barazisë ndërmjet kompanive mëmë, duke përcaktuar p.sh se secilës i është dhënë e drejta të ketë të njëjtin numër përfaqësuesish në organet manaxhuese dhe që asnjë nga anëtarët nuk ka votë vendimtare. Barazia mund të arrihet gjithashtu edhe kur ndërmarrjet mëmë kanë të drejtën që të caktojnë një numër të barabartë anëtarësh në organet vendimarrëse të sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture.



### 3.2. *E drejta e vetos*

- 57.** Kontrolli i përbashkët mund të ekzistojë edhe kur nuk ka barazi ndërmjet dy ndërmarrjeve mëmë për sa i përket votave ose në përfaqësim në organet vendimarrëse ose kur ka më shumë sesa dy ndërmarrje mëmë. Ky është rasti kur aksionerët në pakicë kanë të drejta shtesë, të cilat i lejojnë atyre të marrin vendime vetoje, të cilat janë thelbësore për sjelljen strategjike tregtare të sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture. Këto të drejta vetoje mund të vendosen në statutin e joint venture ose të jepen nëpërmjet marrëveshjes ndërmjet ndërmarrjeve mëmë. Të drejtat e vetos në vetvete mund të ushtrohen nëpërmjet mjeteve të një kuorumi të caktuar, të kërkuar për vendimet që merren në mbledhjet e aksionarëve ose nga bordi i drejtorëve në masën që ndërmarrjet mëmë janë përfaqësuar në këtë bord. Është gjithashtu e mundur që vendimet strategjike të jenë subjekt i miratimit nga një organ, p.sh bordi mbikëqyrës, kur aksionarët e pakicës janë të përfaqësuar dhe pjesëmarrja e tyre është e domosdoshme për të arritur kuorumin e kërkuar për vendime të tilla.
- 58.** Këto të drejta vetoje, duhet të lidhen me vendime strategjike mbi politikën e biznesit të sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture. Ato duhet të shkojnë përtej të drejtës së vetos normalisht të akorduar për aksionarët në minorancë me qëllim që të mbrojnë interesat financiare të tyre si investitorë në joint venture. Kjo mbrojtje normale e të drejtave të aksionarëve të pakicës është e lidhur me vendime mbi thelbin e joint venture, të tilla si ndryshime në statut, një rritje ose zvogëlim i kapitalit apo likuidimi. Një e drejtë vetoje, p.sh e cila ndalon shitjet, nuk akordon kontroll të përbashkët mbi aksionarët e pakicës në fjalë.
- 59.** Në të kundërt, të drejtat e vetos të cilat i japin kontroll të përbashkët, përfshijnë zakonisht vendime mbi çështje të tilla si buxheti, plani i biznesit, investime të mëdha ose caktimi i manaxherëve kryesorë. Përftimi i kontrollit të përbashkët, megjithatë nuk kërkon që përfutuesi të ketë fuqinë që të ushtrojë influencë vendimtare mbi mënyrën se si manaxhohet ndërmarrja ditë pas dite. Elementi kryesor është që të drejtat e vetos janë të mjaftueshme për të mundësuar ndërmarrjen mëmë që të ushtrojë një influencë të tillë në lidhje me sjelljen strategjike të biznesit të joint venture. Për më tepër, nuk është e nevojshme që një përfutues i kontrollit të përbashkët të joint venture të përdorë këtë influencë vendimtare. Mundësia e ushtrimit të një influence të tillë dhe ekzistenca e të drejtës së vetos është e mjaftueshme.
- 60.** Me qëllim që të përftohet kontrolli i vetëm, nuk është e nevojshme për aksionarët e pakicës të kenë të drejtat e vetos të përmendura më sipër. Mund të jetë e mjaftueshme që ai të ketë vetëm një ose disa nga këto të drejta. Nëse është apo jo ky rasti, varet nga konteksti i të drejtës së vetos në vetvete dhe gjithashtu nga rëndësia e kësaj të drejte në kontekstin e këtij biznesi të joint venture.

### *Caktimi i manaxherit kryesor dhe përcaktimi i buxhetit*

- 61.** Shumë të rëndësishme janë të drejtat e vetos që i përkasin vendimeve mbi caktimin dhe shkarkimin e manaxherit kryesor dhe caktimit të buxhetit. Kompetenca për të bashkë-përcaktuar strukturën e manaxhimit kryesor, të tilla si anëtarët e bordit, zakonisht i takon mbajtësit të të drejtave që ushtron influencë vendimtare mbi politikat tregtare të një ndërmarrjeje. E njëjta gjë është e vërtetë në lidhje me vendimet mbi buxhetin, përderisa buxheti përcakton kuadrin e saktë të aktiviteteve të sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture dhe në veçanti të investimeve që mund të kryhen.

### *Plani i biznesit*

- 62.** Plani i biznesit zakonisht parashikon detaje mbi qëllimin e kompanisë së bashku me masat që do të merren me qëllim që të arrihen këto objektiva. Një e drejtë vetoje mbi këtë lloj plan biznesi mund të jetë i mjaftueshëm për të dhënë kontroll të përbashkët edhe në mungesë të ndonjë të drejtë vetoje tjetër. Në të kundërt, kur plani i biznesit përmban deklarata të përgjithshme në lidhje me qëllimin e biznesit të joint venture, ekzistenca e të drejtës së vetos do të jetë vetëm një element në vlerësimin e përgjithshëm të kontrollit të përbashkët dhe nuk do të jetë i mjaftueshëm në vetvete të japë kontroll të përbashkët.

### *Investimet*

- 63.** Në rastin e të drejtës së vetos mbi investimet, rëndësia e të drejtës varet së pari nga niveli i investimeve të cilat janë subjekt i miratimit nga ndërmarrja mëmë dhe së dyti nga shtrirja në të cilën këto investime përbëjnë një element të rëndësishëm në tregun në të cilin joint venture është aktiv. Në lidhje me kriterin e parë, ku niveli i investimeve që ka nevojë që të miratohet nga ndërmarrja mëmë është tepër i lartë, e drejta e vetos mund të jetë më afër mbrojtjes normale të interesave të aksionarëve të pakicës sesa ndaj të drejtës për të akorduar/dhënë kompetenca për të bashkëpërcaktuar një politikë tregtare të joint venture. Në lidhje me të dytën, politika e investimeve të një ndërmarrjeje është normalisht një element i rëndësishëm në vlerësimin nëse ka apo jo kontroll të përbashkët. Megjithatë, mund të ketë disa tregje ku investimet nuk luajnë një rol të rëndësishëm në sjelljen e tregut të një ndërmarrjeje.

### *Të drejtat e veçanta të tregut*

- 64.** Pavarësisht nga të drejtat tipike të vetos të përmendura me sipër, ekziston një numër i të drejtave të tjera të mundshme të lidhura me vendime të veçanta të cilat janë të rëndësishme në kontekstin e një tregu të veçantë të joint venture. Një shembull do të ishte vendimi mbi teknologjinë që do të përdoret nga joint venture, kur teknologjia është një faktor kyç i aktiviteteve të joint venture. Një shembull tjetër lidhet me tregjet që karakterizohen nga diferencimi i produkteve dhe një shkallë e rëndësishme inovacioni/risije (shpikjeje). Në këto tregje, e drejta e vetos mbi vendimet që lidhen me linjat e reja të produkteve që do të zhvillohen nga joint venture, mundet të jetë gjithashtu një element i rëndësishëm i ekzistencës së kontrollit të përbashkët.

## Konteksti i përgjithshëm

**65.** Në vlerësimin e rëndësisë të të drejtës së vetos, këto të drejta nuk duhet të vlerësohen të izoluar nga faktorë të tjerë. Në të kundërt, përcaktimi nëse ekziston apo jo kontrolli i përbashkët, bazohet mbi vlerësimin e këtyre të drejtave si një e tërë. Megjithatë, një e drejtë vetoje e cila nuk lidhet me politika tregtare strategjike por as me caktimin e manaxherëve kryesorë apo me buxhetin ose planet e biznesit, nuk mund të cilësohet se jep kontroll të përbashkët tek zotëruesit e saj.

### 3.3. Ushtrimi i përbashkët i të drejtave të vetos

**66.** Edhe në mungesë të të drejtave specifike të vetos, dy ose më shumë ndërmarrje që përftojnë aksione të pakicës në një ndërmarrje tjetër mund të kenë kontroll të përbashkët. Ky mund të jetë rasti kur aksionarët e pakicës së bashku, kanë mjetet për të kontrolluar ndërmarrjen në fjalë. Kjo nënkupton që aksionerët e pakicës së bashku, do të kenë shumicën e të drejtave të votës, dhe ata do të veprojnë së bashku në ushtrimin e këtyre të drejtave të votës. Kjo mund të çojë në një marrëveshje ligjore detyruese që ka këtë efekt ose të jetë krijuar mbi baza *de facto*.

**67.** Këto mjete ligjore për të siguruar një ushtrim të përbashkët të të drejtave të votës mund të jenë në formën e një shoqërie holding (e kontrolluar bashkërisht) tek e cila aksionarët e pakicës i transferojnë të drejtat e tyre, ose në formën e një marrëveshje nga e cila ata ndërmarrin nismën të veprojnë në të njëjtën mënyrë (*pooling agreement/ marrëveshje grumbulluese*).

**68.** Në raste shumë përjashtimore, veprimet kolektive mund të ndodhin mbi baza *de facto* kur një interes i fortë i përbashkët ekziston ndërmjet aksionarëve të pakicës ndaj efektit se ata nuk mund të veprojnë kundra njëri tjetrit në ushtrimin e të drejtave të tyre në lidhje me sipërmarrjen e përbashkët/ joint venture. Sa më i madh të jetë numri i ndërmarrjeve mëmë të përfshira në një joint venture të tillë, aq më pak e mundshme është mundësia që kjo situatë të ndodhë.

**69.** Treguesit për një interes të përbashkët janë në një shkallë të lartë të varësisë së përbashkët ndërmjet ndërmarrjeve mëmë për të arritur objektiva strategjike të sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture. Kjo është rasti kur secila ndërmarrje mëmë siguron një kontribut për joint venture, i cili është jetësor për operacionet e tij (p.sh. teknologji të veçanta, know-how/ njohuritë lokale ose marrëveshje furnizimi). Në këto rrethana, ndërmarrjet mëmë mund të jenë në gjendje që të bllokojnë vendime strategjike të joint venture dhe të manaxhojnë joint venture në mënyrë të suksesshme vetëm me marrëveshje me njëra tjetrën në lidhje me vendime strategjike edhe kur nuk ka dispozita të shprehura për ndonjë të drejtë vetoje. Ndërmarrjeve mëmë si rrjedhojë do tu kërkohet që të bashkëpunojnë. Faktorë të tjerë janë procedurat lidhur me vendimarrjen të cilat janë të dizenuara në mënyrë të tillë që të lejojnë ndërmarrjet mëmë që të ushtrojnë kontrollin e përbashkët edhe në rastet e mungesës së një marrëveshjeje të shprehur që garanton të

drejtën e vetos ose lidhje të tjera ndërmjet aksionarëve të pakicës që lidhen me joint venture .

70. Një skenar i tillë nuk ndodh vetëm në situatën kur dy ose më shumë aksionarë të pakicës bashkërisht kontrollojnë një ndërmarrje mbi baza *de facto*, por gjithashtu edhe kur ka një shkallë të lartë të varësisë të aksionarëve të shumicës mbi aksionarët e pakicës. Ky mund të jetë rasti ku joint venture ekonomikisht dhe financiarisht varet nga aksionarët e pakicës ose kur një aksionar i vetëm i pakicës ka njohuritë (know-how) e kërkuara për këtë dhe do të luajë një rol kryesor në operacionet e ndërmarrjes së përbashkët ku aksionari i shumicës është një investitor i mirëfilltë financiar. Në këto rrethana, aksionarët e shumicës nuk do të jenë në gjendje që të forcojnë pozitat e tyre, por partneri i joint venture mund të jetë në gjendje që të bllokojë vendimet strategjike në mënyrë të tillë që të dy ndërmarrjeve mëmë do tu kërkohej që të bashkëpunojnë në mënyrë të përhershme. Kjo çon në një situatë të kontrollit të përbashkët *de facto* i cili i paraprin një vlerësimi të pastër *de jure* në lidhje më të cilin aksionarët e shumicës do të ishin konsideruar se kanë kontroll të vetëm.
71. Këto kritere zbatohen për krijimin e një joint venture të ri si edhe për përfitim të aksioneve të pakicës, të cilët së bashku akordojnë kontrollin e përbashkët. Në rastin e përfimit të aksioneve, ka një probabilitet të lartë të një interesi të përbashkët nëse aksionet janë përftuar nëpërmjet aksioneve të bashkërenduara. Megjithatë, një përfitim nëpërmjet një aksioni të bashkërenduar nuk është në vetvete i mjaftueshëm për qëllime të krijimit të kontrollit të përbashkët *de facto*. Në përgjithësi, një interes i përbashkët për investitorët financiarë (ose kreditorët) të një kompanie, në kthim të investimeve nuk përbën një interes të përbashkët që çon në ushtrimin e kontrollit të përbashkët *de facto*.
72. Në mungesë të interesit të fortë të përbashkët të tillë si ato të nënvizuara më lart, mundësia e ndryshimit të koalicionit ndërmjet aksionarëve të pakicës normalisht do të përjashtojë ekzistencën e kontrollit të përbashkët. Kur nuk ka shumicë të qëndrueshme në procedurat e vendimmarrjes dhe shumica mundet në çdo rast të jetë ndonjë nga kombinimet e ndryshme të mundshme ndërmjet aksionarëve të pakicës, nuk mund të supozohet se aksionarët e pakicës (ose një grup i caktuar) do të kontrollojnë bashkërisht ndërmarrjen. Në këtë kuptim, nuk është e mjaftueshme që ekzistojnë marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve që kanë aksione të barabarta në kapitalin e një ndërmarrjeje, që sjell të drejta dhe fuqi të njëjta ndërmjet palëve, kur kjo dështon në të drejtat strategjike të vetos. P.sh. në rastin e një ndërmarrjeje ku tre aksionarë zotëron secili nga 1/3 të kapitalit aksionar dhe secili zgjedh 1/3 e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, aksionarët nuk kanë kontroll të përbashkët për sa kohë vendimet kërkohej të merren mbi baza të shumicës së thjeshtë.

#### 3.4. Konsiderata të tjera lidhur me kontrollin e përbashkët

##### *Roli jo i barabartë i ndërmarrjeve mëmë*

73. Kontrolli i përbashkët nuk është i papajtueshëm me faktin se një nga ndërmarrjet mëmë ka njohuri të veçanta dhe eksperiencë në biznesin e joint venture. Në një rast të tillë, ndërmarrja tjetër mëmë mund të luajë një rol modest ose fare të padukshëm në manaxhimin ditor të joint venture, kur prezenca është e motivuar nga strategji afatgjata,

financiare dhe që kanë një natyrë me politikë të gjerë. Pavarësisht kësaj, duhet gjithmonë që të mbahet parasysh mundësia reale e kontestimit të vendimeve të marra nga ndërmarrje të tjera mëmë mbi baza të barazisë së të drejtave të votës ose të drejtës që të caktojnë organet vendimarrëse ose të drejtat e vetos në lidhje me çështje strategjike. Pa këtë, kjo do të ishte kontroll i vetëm.

#### *Vota vendimtare/vota e kryetarit*

**74.** Në mënyrë që të ekzistojë kontrolli i përbashkët, jo vetëm njëra nga ndërmarrjet mëma duhet të ketë një votë vendimtare pasi kjo do të çonte në një kontroll të vetëm nga kjo ndërmarrje. Megjithatë, mund të ketë kontroll të vetëm, kur vota vendimtare është në praktikë me efektivitet dhe përkatësi të kufizuar. Ky mund të jetë rasti kur vota vendimtare mund të ushtrohet vetëm pas një serish fazash arbitrazhi dhe synon të bashkërendojë ose në një fushë shumë të kufizuar ose nëse ushtrimi i votës vendimtare kërkon ndërhyrjen e një detyrimi serioz financiar ose nëse ndërvarësia e përbashkët e ndërmarrjeve mëmë do të bënte të pamundur ushtrimin e votës vendimtare.

#### II. Ndryshime në cilësinë e kontrollit

**75.** Dispozitat mbi përqendrimet përfshijnë transaksionet që vijnë si rezultat i përfundimit të kontrollit të vetëm ose të përbashkët, përfshirë transaksionet që çojnë në ndryshimin e cilësisë së kontrollit. *Së pari*, një ndryshim i tillë i cilësisë së kontrollit, që rezulton në një përqendrim, ndodh nëse ka një ndryshim ndërmjet kontrollit të përbashkët dhe atij të vetëm. *Së dyti*, një ndryshim në cilësinë e kontrollit ndodh ndërmjet skenarëve të kontrollit të përbashkët para dhe pas transaksionit, nëse ka një rritje të numrit ose një ndryshim të identitetit të aksionarëve kontrollues. Megjithatë, nuk ka ndryshim në cilësinë e kontrollit nëse ndryshimi ndodh nga kontrolli i vetëm negativ, në atë të vetëm pozitiv. Një ndryshim i tillë nuk ndikon as nismat e aksionarëve kontrollues negativ, as natyrën e strukturës së kontrollit, duke qenë se aksionarët kontrollues jo domosdoshmërisht kanë bashkëpunuar me aksionarët e veçantë në kohën kur ata kishin kontrollin negativ. Në çdo rast, ndryshime të caktuara në nivelin e aksioneve të të njëjtëve aksionarë kontrollues, pa ndryshime në fuqitë/kompetencat që ata kanë në kompani dhe në përbërjen e strukturës kontrolluese të kompanisë, nuk përbën një ndryshim në cilësinë e kontrollit dhe si rrjedhojë nuk përbëjnë një përqendrim për tu njoftuar. Këto ndryshime në cilësinë e kontrollit do të diskutohen në dy kategori: së pari hyrja e një ose më shumë aksionarëve kontrollues të rinj pavarësisht nëse ata zëvendësojnë apo jo aksionarët kontrollues ekzistues dhe së dyti, një zvogëlim i numrit të aksionarëve kontrollues.

#### 1. Hyrja e aksionarëve kontrollues

**76.** Hyrja e aksionarëve të rinj kontrollues, që çon në një skenar të kontrollit të përbashkët, mund të rezultojë ose nga një ndryshim i kontrollit të vetëm në kontroll të përbashkët ose nga hyrja e aksionarëve shtesë ose zëvendësimi i aksionarëve ekzistues në një ndërmarrje tashmë të kontrolluar bashkërisht.

77. Një lëvizje nga një kontroll i vetëm në një kontroll të përbashkët konsiderohet si një transaksion që duhet njoftuar, duke qenë se kjo ndryshon cilësinë e kontrollit të joint venture. *Së pari*, ka një përfitim të ri të kontrollit për aksionarët që hyjnë në një ndërmarrje të kontrolluar. *Së dyti*, vetëm përfytesit e rinj të kontrollit e bëjnë ndërmarrjen kontrolluese një joint venture, e cila ndryshon në mënyrë vendimtare situatën për ndërmarrjen kontrolluese që ngelet. Në të ardhmen, duhet të merret në konsideratë interesi i një ose më shumë aksionarëve kontrollues dhe kërkohet që të bashkëpunohet në mënyrë të përhershme me aksionarët e rinj. Më përpara, mundet ose të përcaktohet sjellja strategjike e ndërmarrjes së kontrolluar vetëm (në rastin e kontrollit të vetëm) ose nuk ishte e detyrueshme të merrej në konsideratë interesi i aksionarëve të tjerë të veçantë dhe nuk ishte e detyrueshme të bashkëpunohet me këta aksionarë në mënyrë të përhershme.
78. Hyrja e aksionarëve të rinj në një ndërmarrje të kontrolluar bashkërisht ose duke shtuar numrin e aksionarëve tashmë kontrollues ose duke zëvendësuar një nga ata – gjithashtu përbën një përqendrim që duhet njoftuar, pavarësisht se ndërmarrja kontrollohet bashkërisht para dhe pas operacionit. *Së pari*, gjithashtu në këtë skenar ka një aksionar i cili rishtaz përfiton kontrollin e joint venture. *Së dyti*, cilësia e kontrollit të joint venture përcaktohet duke identifikuar të gjithë aksionarët kontrollues. Kjo shtrihet në natyrën e kontrollit të përbashkët, që duke qenë se secili aksioner së vetmi ka të drejta bllokuese në lidhje me vendime strategjike, aksionarët kontrollues të përbashkët duhet të marrin në konsideratë interesat e njëri tjetrit dhe u kërkohet që të bashkëpunojnë për përcaktimin e sjelljeve strategjike në një sipërmarrje të përbashkët/ joint venture. Natyra e kontrollit të përbashkët në këtë mënyrë nuk çon në vetvete në një shtesë të thjeshtë matematikore të të drejtave bllokuese që ushtrojnë disa aksionarë, por është i përcaktuar nga përbërja e aksionarëve që kontrollojnë bashkërisht. Një nga skenarët më të njohur që çon në një ndryshim vendimtar të natyrës së strukturës kontrolluese të ndërmarrjes së kontrolluar bashkërisht, është situata ku në një sipërmarrje të përbashkët/ joint venture, e kontrolluar bashkërisht nga një konkurrues i joint venture dhe një investitor financiar, investitori financiar zëvendësohet nga një konkurrues tjetër. Në këto rrethana, struktura kontrolluese dhe nisma e joint venture mund të ndryshojë rrënjësisht, jo vetëm nga hyrja e aksionarëve të rinj kontrollues por gjithashtu edhe si pasojë e ndryshimeve në sjelljen e aksionarëve që kanë ngelur. Zëvendësimi i aksionarëve kontrollues ose hyrja e aksionarëve të rinj në një ndërmarrje të kontrolluar bashkërisht përbën kështu një ndryshim në cilësinë e kontrollit.
79. Megjithatë, hyrja e aksionarëve të rinj do të çojë në një përqendrim që duhet njoftuar, vetëm kur një ose më shumë aksionarë përftojnë kontrollin e vetëm ose të përbashkët si pasojë e një operacioni. Hyrja e aksionarëve të rinj mund të çojë në një situatë ku kontrolli i përbashkët mundet ose të krijohet mbi baza *de jure* ose *de facto*, duke qenë se hyrja e aksionarëve të rinj çon në pasoja të tilla që ndryshimi i koalicioneve ndërmjet aksionarëve të pakicës është i mundur.

## 2. Reduktimi/Zvogëlimi i numrit të aksionarëve

80. Reduktimi/zvogëlimi i numrit të aksionarëve kontrollues përbën një ndryshim të cilësisë së kontrollit dhe në këtë mënyrë konsiderohet si një përqendrim nëse dalja e një ose më

shumë aksionarëve kontrollues rezulton në një ndryshim të kontrollit nga kontrolli i përbashkët në atë të vetëm. Influenca vendimmarrëse që ushtrohet së vetmi është thelbësisht e ndryshme nga influenca vendimmarrëse që ushtrohet bashkërisht, përderisa në rastin e fundit aksionarët kontrollues të përbashkët duhet të marrin parasysh interesat e ndryshme të mundshme të palëve të tjera të përfshira. Kur operacioni përfshin një reduktim të numrit të aksionarëve kontrollues të përbashkët, pa çuar në një ndryshim të kontrollit nga ai i përbashkët në atë të vetëm, transaksioni normalisht nuk do të çojë në një përqendrim që duhet të njoftohet.

#### **IV. SIPËRMARRJET E PËRBASHKËTA/ JOINT VENTURES — Koncepti i funksionit të plotë**

- 81.** Një përqendrim ekziston kur është përftuar kontrolli nga një ose më shumë ndërmarrje të një ndërmarrjeje tjetër të tërë, ose pjese të saj. Përftimi i ri i një ndërmarrjeje tjetër nga disa ndërmarrje që kontrollojnë bashkërisht, përbën një përqendrim. Si në rastin e përftimit të kontrollit të vetëm të një ndërmarrjeje, një përftim i tillë i kontrollit të përbashkët do të çojë në një ndryshim strukturor të tregut, edhe kur sipas planeve të ndërmarrjes përftuese, ndërmarrja që përfitohet nuk do të konsiderohet më tej si me funksione të plota pas transaksionit (p.sh sepse ajo do të shesë ekskluzivisht tek ndërmarrja mëmë në të ardhmen). Në këtë mënyrë, një transaksion i cili përfshin disa ndërmarrje që përfitojnë kontrollin e përbashkët të një ndërmarrjeje tjetër ose pjesë të një ndërmarrjeje tjetër, duke plotësuar kriteret e vendosura në paragrafin 20, nga palë të treta, do të përbëjë një përqendrim pa qenë e nevojshme që të merret në konsideratë kriteri i funksioneve të plota.
- 82.** Krijimi i një sipërmarrjeje të përbashkët/ joint venture bazuar në një qëndrueshmëri të gjatë të të gjithë funksioneve të një entiteti të pavarur ekonomik (të ashtuquajtur joint venture me funksione të plota) përbën një përqendrim. Kriteri i funksioneve të plota paraqet zbatueshmërinë e dispozitave mbi përqendrimet lidhur me krijimin e sipërmarrjeve të përbashkëta/ joint ventures nga palët, pavarësisht nëse një joint venture e tillë është krijuar si një *'operacion greenfield'* ose nëse palët kontribuojnë me asete në joint venture të cilat më parë ishin të zotëruara individualisht. Në këto rrethana, sipërmarrja e përbashkët/ joint venture duhet të plotësojë kriterin e funksioneve të plota për të përbërë një përqendrim.
- 83.** Fakti që një joint venture mund të jetë një ndërmarrje me funksione të plota dhe si rrjedhim ekonomikisht e pavarur nga një këndvështrim operacional, nuk nënkupton që ajo ka autonomi për sa i përket marrjes së vendimeve strategjike. Përndryshe, një ndërmarrje e kontrolluar bashkërisht nuk do të konsiderohej asnjëherë si një joint venture me funksione të plota dhe si rrjedhim kushti sipas nenit 10/1/c nuk do të plotësohej asnjëherë. Si pasojë është e mjaftueshme për kriterin e funksioneve të plota nëse sipërmarrja e përbashkët/ joint venture është e pavarur në lidhje me aspektet operationale.

1. Burime të mjaftueshme për të operuar në mënyrë të pavarur në treg

**84.** Karakteri i funksioneve të plota nënkupton që një sipërmarrje e përbashkët/ joint venture duhet të ushtrojë aktivitetet në treg, duke kryer transaksionet normalisht të ndërmarrja nga një ndërmarrje që operon në të njëjtin treg. Me qëllim që të veprojë në këtë mënyrë, sipërmarrja e përbashkët/ joint venture duhet të ketë një manaxhim të dedikuar operacioneve të tij ditë pas dite dhe të ketë akses tek burimet e mjaftueshme përfshirë edhe ato financiare, stafin dhe asetet, (të trupëzuara dhe të patrupëzuara) me qëllim që të kryejë mbi baza të qëndrueshme aktivitetet e tij të biznesit brenda zonës të ofruar nga marrëveshja e joint venture. Personeli jo domosdoshmërisht nevojitet që të punësohet nga vetë sipërmarrja e përbashkët/ joint venture. Nëse është një praktikë standarde në industrinë ku sipërmarrja e përbashkët/ joint venture po operon, mund të jetë e mjaftueshme nëse palët e treta e përballojnë stafin sipas një marrëveshjeje operacionale ose nëse stafi është marrë nga një agjenci punësimi. Punësimi i personelit nga ndërmarrjet mëmë mund të jetë i mjaftueshëm nëse kjo bëhet ose vetëm për një periudhë kohore fillestare ose nëse vetë sipërmarrja e përbashkët/ joint venture bie dakord me shoqërinë mëmë në të njëjtën mënyrë si më palët e treta. Rasti i fundit kërkon që sipërmarrja e përbashkët/ joint venture të bjerë dakord me kompanitë mëmë mbi baza të kushteve normale tregtare dhe që sipërmarrja e përbashkët/ joint venture është gjithashtu e lirë të zgjedhë për të rekrutuar punonjësit e vet ose të marrë staf nëpërmjet palëve të treta.

## 2. Aktivitetet sipas një funksioni të veçantë për ndërmarrjet mëmë

**85.** Një sipërmarrje e përbashkët/joint venture nuk ka funksione të plota nëse merr vetëm një funksion të veçantë brenda aktiviteteve të biznesit të ndërmarrjeve mëmë pa patur akses të vetin ose prezencë në treg. Ky është rasti p.sh për sipërmarrje të përbashkëta/ joint ventures të kufizuara në kërkim zhvillim ose prodhim. Këto sipërmarrje të përbashkëta/ joint ventures janë ndihmëse për aktivitetet e biznesit të ndërmarrjeve mëmë. Ky është gjithashtu rasti kur një sipërmarrje e përbashkët/ joint venture është e kufizuar vetëm për shpërndarjen ose shitjen e produkteve të ndërmarrjes së vet mëmë dhe si rrjedhojë vepron fillimisht si një agjenci shitjesh. Megjithatë, fakti që një sipërmarrje të përbashkët/ joint venture përdor rrjetin e shpërndarjes të një ose më shumë ndërmarrjeve mëmë normalisht nuk ndalon që të kualifikohet si me “funksione të plota” për sa kohë që ndërmarrjet mëmë veprojnë vetëm si agjentë të sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture.

**86.** Një shembull tipik ku kjo pyetje shtrohet është rasti kur sipërmarrjet e përbashkëta/ joint ventures janë përfshirë në një shoqëri të pronësisë së pasurive të paluajtshme, të cilat krijohen për taksat dhe arsye të tjera financiare. Për sa kohë që qëllimi i sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture është i kufizuar në përfitim dhe/ose mbajtjen e disa pasurive të paluajtshme për ndërmarrjet mëmë dhe bazuar në burimet financiare të ofruara nga ndërmarrjet mëmë, zakonisht nuk do të konsiderohen si me funksione të plota, për sa kohë nuk ka autonomi, aktiviteti biznesi në terma afatgjatë në treg dhe gjithashtu ka mungesë për sa i përket burimeve të nevojshme për të ushtruar aktivitetet në mënyrë të pavarur. Kjo duhet të dallohet nga sipërmarrjet e përbashkëta/ joint ventures që janë aktive në manaxhimin e portofolit të pasurive të paluajtshme dhe që veprojnë për llogari të tyre në treg, të cilat janë forma e zakonshme që tregojnë funksione të plota.

## 3. Lidhjet Shitje/Blerje me ndërmarrjet mëmë



**87.** Prezenca e fortë e ndërmarrjeve mëmë në tregun e rrjedhës së sipërme dhe të poshtme është një faktor që duhet të merret në konsideratë në vlerësimin e karakterit të funksioneve të plota në një sipërmarrje të përbashkët/ joint venture ku kjo prezencë rezulton në shitje të rëndësishme ose blerje të rëndësishme ndërmjet ndërmarrjeve mëmë dhe sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture. Fakti se vetëm për një periudhë fillestare sipërmarrja e përbashkët/ joint venture mbështetet pothuajse plotësisht mbi shitjet ose blerjet nga ndërmarrjet e veta mëmë normalisht nuk ndikon karakterin e vet të funksioneve të plota. Një periudhë e tillë fillestare mund të jetë e nevojshme me qëllim që sipërmarrja e përbashkët/ joint venture të krijojë një pozicion të qëndrueshëm në treg. Por kjo periudhë normalisht nuk do të tejkalojë periudhën prej 3 vitesh, që varet nga kushtet e veçanta të tregut në fjalë.

#### *Shitje tek ndërmarrjet mëmë*

**88.** Kur shitjet nga sipërmarrja e përbashkët/ joint venture tek ndërmarrjet mëmë bëhen mbi baza të qëndrueshme, pyetja kryesore është nëse pavarësisht nga këto shitje, sipërmarrja e përbashkët/ joint venture është e aftë të luajë një rol aktiv në treg dhe mund të konsiderohet si ekonomikisht e pavarur nga njw pikëpamje operationale. Në këtë këndvështrim, proporcioni relativ i shitjeve të bëra për ndërmarrjet mëmë, i cili krahasohet me prodhimin total të sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture është një faktor i rëndësishëm. Bazuar në veçantitë e secilit rast individual, është e pamundur që të përcaktohet një kufi i veçantë xhiroje, i cili dallon funksionet e plota nga joint venture të tjera. Nëse sipërmarrja e përbashkët/ joint venture arrin më tepër se sa 50 % të xhiros së saj me palë të treta, kjo do të ishte një tregues tipik i funksioneve të plota. Nën këtë kufi tregues, do të kërkohet një analizë rast pas rasti, dhe në lidhje me pavarësinë operationale, lidhja ndërmjet sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture dhe ndërmarrjeve të saj mëmë duhet të ketë karakter tregtar. Për këtë qëllim, duhet të tregohet se sipërmarrja e përbashkët/ joint venture do të ofrojë të mirat dhe shërbimet e tij tek blerësi, i cili i vlerëson ato me tepër dhe do të paguajë me tepër, dhe se joint venture do të merret gjithashtu me ndërmarrjet mëmë mbi baza të kushteve normale tregtare. Nën këto rrethana, d.m.th nëse joint venture do të trajtojë ndërmarrjet e tij mëmë në të njëjtën mënyrë tregtare si dhe palët e treta, mund të jetë e mjaftueshme që të paktën 20 % e shitjeve të parashikuara të joint venture do të shkojë tek palët e treta. Megjithatë, sa më i madh proporcioni i shitjeve të mundshme që të bëhen për kompanitë mëmë, aq më e madhe do të jetë kërkesa për të dhëna të qarta të karakterit tregtar të kësaj lidhjeje.

**89.** Për përcaktimin e proporcionalitetit ndërmjet shitjeve tek ndërmarrjet mëmë dhe te palët e treta, duhet të merren në konsideratë llogaritje të kaluara dhe plane biznesi të rëndësishme. Megjithatë, veçanërisht kur shitjet tek palët e treta të rëndësishme nuk mund të parashikohen me lehtësi, duhet të analizohet struktura e përgjithshme e tregut. Ky mund të jetë një faktor i rëndësishëm edhe për vlerësimin nëse sipërmarrja e përbashkët/ joint venture do të merret me ndërmarrjet e veta mëmë.

90. Këto çështje zakonisht ngrihen në rastet e marrëveshjeve ku kërkohen burime nga jashtë shoqërisë/ outsourcing, ku një ndërmarrje krijon një sipërmarrje të përbashkët/ joint venture me një ofrues shërbimesh, i cili do të ndërmarrë funksione që më parë trajtoheshin nga vetë ndërmarrja brenda përbrenda. Sipërmarrja e përbashkët/ joint venture nuk mund të konsiderohet se është me funksione të plota në këto skenarë: ofron shërbimet e veta ekskluzivisht për klientët, dhe është e varur për shërbimet e veta mbi lëndët e para nga ofruesi i shërbimeve. Fakti që shpesh plani i biznesit të sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture nuk përjashton faktin që joint venture të ofrojë shërbimet e veta tek palët e treta, nuk e ndryshon këtë vlerësim, pasi në një situatë tipike të burimeve nga jashtë/ outsourcing është e mundur që çdo hyrje nga palët e treta të jetë dytësore kundrejt aktivitetit kryesor të joint venture për klientin. Megjithatë, rregulli i përgjithshëm nuk përjashton që mund të ketë situata të burimeve nga jashtë/ outsourcing ku partnerët e joint venture, p.sh për arsye të ekonomive të shkallës, krijojnë një joint venture me perspektivën e aksesit domethënës në treg. Kjo mund ta kualifikojë sipërmarrjen e përbashkët/ joint venture si me funksione të plota nëse shitjet e rëndësishme tek palët e treta janë parashikuar dhe nëse lidhja ndërmjet sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture dhe ndërmarrjeve të tij mëmë do të ketë tërësisht karakter tregtar dhe nëse sipërmarrja e përbashkët/ joint venture merret/ hyn në marrëdhënie me ndërmarrjet e veta mëmë mbi baza të kushteve normale tregtare.

#### *Blerjet nga ndërmarrjet mëma*

91. Për sa i përket blerjeve të bëra nga sipërmarrja e përbashkët/ joint venture tek mëmat e saj, tërësia e funksionimit të sipërmarrjes së përbashkët është e dyshimtë sidomos në rastet në të cilat vlera që ajo i shton produkteve ose shërbimeve të blera është modeste/ e vogël. Në një situatë të tillë sipërmarrja e përbashkët mund të konsiderohet më shumë si një agjent shitjesh e përbashkët.

#### *Tregje komerciale/tregtare*

92. Megjithatë, ndryshe nga sa u ilustrua në fillim, kur sipërmarrja e përbashkët ushtron aktivitet në një treg komercial dhe zhvillon funksionet që normalisht janë karakteristike të një ndërmarrje tregtare në këtë treg, ajo nuk do të konsiderohet normalisht si një agjent shitjesh ndihmës, por si një sipërmarrje e përbashkët me titull të plotë. Një treg komercial normalisht karakterizohet nga prezenca në këtë treg e shoqërive të cilat janë të specializuara në shitjen dhe shpërndarjen e produkteve pa qenë të integruara vertikalisht, krahas shoqërive të cilat janë të tilla, dhe nga disponueshmëria e burimeve të ndryshme të furnizimit të këtyre produkteve. Gjithashtu, në shume tregje komercialë operatorët duhet të investojnë në pikat e shitjes, rezervat e produkteve, magazina, depozitat, parkingje si dhe për personelin për shitjet. Për të qenë një ndërmarrje me titull të plotë në një treg komercial, një sipërmarrje e përbashkët/ joint venture duhet të disponojë infrastrukturën e nevojshme për të marrë një kuotë të rëndësishme të furnizimeve jo vetëm nga ndërmarrjet mëma por edhe nga burime të tjera konkurrenente me këto të fundit.

#### **4. Natyra e qëndrueshme e veprimtarisë së ndërmarrjes**

- 93.** Sipërmarrja e përbashkët/ joint venture duhet të jetë krijuar me qëllimin për të pasur qëndrueshmëri në aktivitet. Fakti që ndërmarrjet mëma i japin sipërmarrjes së përbashkët burimet e sipërpërmendura normalisht mjafton të provohet. Përveç kësaj, marrëveshjet e themelimit të një sipërmarrje të përbashkët shpesh parashikojnë mundësi të caktuara si p.sh mos suksesin e sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture ose një konflikt të rëndësishëm ndërmjet ndërmarrjeve mëma. Ndonjëherë, parashikohet me dispozita të cilat parashikojnë mundësinë e shpërbërjes së sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture ose mundësinë që njëra ose të gjitha ndërmarrjet mëma të tërhiqen nga kjo e fundit. Këto lloj dispozitash nuk pengojnë që sipërmarrja e përbashkët/ joint venture të konsiderohet si një ndërmarrje, e cila është e destinuar të funksionojë për një kohë të gjatë. I njëjti arsyetim vlen normalisht edhe për rastet kur marrëveshja (akti) i/e themelimit parashikon që ndërmarrja do të ketë një kohëzgjatje të caktuar, për sa kohë kjo do të jetë e nevojshme që të sjellë një ndryshim të rëndësishëm në strukturën e ndërmarrjeve që bëjnë pjesë, ose kur kjo marrëveshje parashikon mundësinë që sipërmarrja e përbashkët/ joint venture të vazhdojë aktivitetin e saj edhe pas afatit të vendosur.
- 94.** Në të kundërt, konsiderohet që sipërmarrja e përbashkët nuk është e destinuar të kryejë aktivitet të përhershëm kur themelohet për një kohëzgjatje shumë të shkurtër. Kjo mundësi shfaqet p.sh, kur sipërmarrja e përbashkët/ joint venture themelohet për të përmbyllur një projekt të veçantë, si ndërtimi i një centrali elektrik, por nuk ka për qëllim që të marrë pjesë në ushtrimin e aktivitetit të centralit, pasi të mbarojë ndërtimin.
- 95.** Një sipërmarrje e përbashkët nuk vepron mbi një bazë jetëgjatë në një fazë në të cilën janë pezulluar të gjitha vendimet e të tretëve, të cilat janë thelbësore për të filluar aktivitetin ekonomik të sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture. Vendimet duhet të jenë vendime të cilat shkojnë përtej formaliteteve të thjeshta, natyra e të cilave zakonisht është e paqartë. Shembujt të këtij lloji janë dhënia e një kontrate (p.sh për prokurimet publike), licencat (p.sh në sektorin e telekomunikacionit) ose të drejtat e hyrjes në pronë (p.sh të drejtat për eksplorimin për naftën dhe gazin). Në pritje të këtyre vendimeve mbi këto faktorë është e paqartë nëse sipërmarrja e përbashkët do të jetë funksionale. Në këtë fazë nuk mund të thuhet se ajo kryen funksione ekonomike të qëndrueshme dhe për pasojë ajo nuk kualifikohet si një sipërmarrje e përbashkët me titull të plotë. Megjithatë, pasi merret një vendim që i përket sipërmarrjes së përbashkët, ky kriter plotësohet dhe në këtë rast kemi një përqendrim.

## **5. Ndryshime të veprimtarisë së sipërmarrjes së përbashkët**

- 96.** Ndërmarrjet mëmë mund të vendosin të zgjerojnë aktivitetin e sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture gjatë ekzistencës së saj. Ky fakt do të konsiderohet si një përqendrim i ri i cili mund të jetë objekt i detyrimit për njoftim nëse zgjerimi sjell përfundimin nga ndërmarrjet mëma të një ndërmarrjeje tjetër apo të një pjese të saj e cila, më vete do të konsiderohej përqendrim.
- 97.** Mund të kemi një përqendrim edhe në rast se ndërmarrjet mëma transferojnë një pjesë të konsiderueshme të aktiveve shtesa (aseteve), kontrata, njohuri/ know-how ose të drejta të tjera të sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture dhe këto aktive ose të drejta përbëjnë bazën për zgjerimin e aktiviteteve të sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture në tregje të

tjerë gjeografikë apo të produktit të cilat nuk ishin objekt i sipërmarrjes së përbashkët fillestare dhe nëse sipërmarrja e përbashkët zhvillon një aktivitet të tillë si ndërmarrje me titull të plotë. Zgjerimi i aktivitetit të sipërmarrjes së përbashkët mund të konsiderohet si *themelim* i një sipërmarrje të përbashkët, pasi transferimi i aktiveve/aseteve ose i të drejtave tregojnë se janë ndërmarrjet mëma subjektet reale të zgjerimit të aktivitetit fushës të sipërmarrjes së përbashkët.

- 98.** Nëse shtrirja/ qëllimi i sipërmarrjes së përbashkët është zgjerimi pa transferimin e aktiveve shtesë (aseteve), kontrata, njohuri/ know-how ose të drejta të tjera, atëherë do të konsiderohet se nuk ka një përqendrim.
- 99.** Një përqendrim krijohet atëherë kur në aktivitetin e një sipërmarrje të përbashkët/ joint venture ekzistuese, e cila nuk është një sipërmarrje e përbashkët/ joint venture me titull të plotë, verifikohet një ndryshim i tillë i cili të shkaktojë lindjen e një sipërmarrje të përbashkët/ joint venture me titull të plotë. Shembuj të këtij rasti janë sipërmarrjet e përbashkëta të cilat ndryshojnë strukturën e tyre organizative për të përmbushur kriterin e sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture me titull të plotë; sipërmarrjet e përbashkëta/ joint ventures të cilat më parë furnizonin vetëm ndërmarrjet mëmë dhe që më vonë nisin një aktivitet të rëndësishëm në treg; ose situatat (sipas pikës 96) në të cilën një sipërmarrje e përbashkët/ joint venture mund të nisë aktivitetin e saj në treg pasi të ketë përftuar një kontribut thelbësor (si p.sh licenca për një sipërmarrje të përbashkët/ joint venture, e cila operon në tregun e telekomunikacioneve). Një ndryshim i tillë në aktivitetin e sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture shpesh kërkon një vendim nga ana e ortakëve ose e aksionareve kontrollues. Pasi merret vendimi i cili çon në përmbushjen e kriterit të sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture e me titull të plotë, atëherë kemi të bëjmë me një përqendrim.

## V Përrjashtime

- 100.** Megjithatë, parashikohen tre situata të jashtëzakonshme në të cilat përftimi i një pjesëmarrje kontrolluese nuk përbën një përqendrim.
- 101.** *Së pari*, nuk konsiderohet përqendrim përftimi/blerja e investimeve/ mjete financiare nga ana e shoqërisë, aktiviteti normal i së cilës përfshin shitblerjen ose ndërmjetësimin e titujve për llogari të vetën ose të të tretëve, nëse përftimi /blerja është kryer në kontekstin e këtij aktiviteti me kusht që titujt të zotërohen përkohësisht. Për të qenë pjesë e këtij përjashtimi duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:
- ndërmarrja blerëse duhet të jetë një ent/institut kredie, ose institut financiar i tjetër lloji ose një shoqëri sigurimesh, aktiviteti normal i së cilës përputhet me përshkrimin më sipër;
  - titujt duhet të përftohen me qëllim rishitje;
  - ndërmarrja blerëse nuk duhet të ushtrojë të drejtat e votës me qëllimin për të vendosur mbi strategjitë e aktivitetit të ndërmarrjes së përftuar dhe aq më pak të ushtrojë këto të drejta vetëm për të përgatitur një tjetërsim total ose të pjesshëm të ndërmarrjes, të aktiviteve përkatëse ose të pjesëmarrjes/ mjeteve financiare;
  - ndërmarrja blerëse duhet të tjetërsojë/ transferojë pjesëmarrjen kontrolluese të saj brenda një viti nga blerja, në mënyrë që të pakësojë, brenda kësaj periudhe, pjesëmarrjen të

paktën në një nivel në të cilin nuk ka më kontrollin. Ky afat mund të shtyhet nga Komisioni, kur ndërmarrja përfutuese provon që transferimi nuk mund të jetë i arritshëm brenda afatit prej një viti.

- 102.** *Së dyti*, nuk ka ndryshim të strukturës së kontrollit dhe për pasojë nuk krijohet një përqendrim kur kontrolli përftohet nga një person i cili ka marrë mandatin nga një autoritet publik në përputhje me legjislacionin në fuqi në lidhje me likuidimin, falimentimin, paaftësinë paguese, pushimit të pagesave, akordimit ose procedurave të tjera të ngjashme.
- 103.** *Së treti*, nuk krijohet një përqendrim në rastin kur kontrolli përftohet nga një shoqëri financiare. Koncepti i “shoqërisë holding me pjesëmarrje financiare” është i kufizuar për shoqërinë, objekti i së cilës është vetëm pjesëmarrja në shoqëri të tjera, pa ndërhyrë në mënyrë direkte apo indirekte në manaxhimin/ drejtimin e këtyre ndërmarrjeve, duke përjashtuar të drejtat që shoqëria me pjesëmarrje financiare zotëron në cilësi të aksionarit apo ortakut. Këto shoqëri investimesh duhet të strukturohen në mënyrë të tillë që respektimi i kufizimeve, i vendosur për aktivitetet e tyre, të kontrollohet nga një autoritet gjyqësor apo administrativ. Megjithatë, parashikohet një kusht tjetër për zbatimin e këtij përjashtimi: këto shoqëri mund të ushtrojnë të drejtën e votës në ndërmarrje të tjera për të mbrojtur vlerën e plotë të investimit dhe jo për të vendosur në mënyrë direkte apo indirekte mbi sjelljen konkurruese të ndërmarrjes së kontrolluar .
- 104.** Përjashtimet zbatohen vetëm në raste shumë të kufizuara. Në radhë të parë, zbatohen vetëm nëse operacioni mund të kishte qenë një përqendrim në vetvete, por jo nëse operacioni është pjesë e një përqendrimi tjetër më të gjerë, në kushte në të cilat përfutuesi përfundimtar i kontrollit nuk i plotëson kushtet (shih pikën 35). Në radhë të dytë, përjashtimet zbatohen vetëm në rastet e përfutimit të kontrollit nëpërmjet përfutimit të pjesëmarrjes në kapital dhe jo nëpërmjet përfutimit të elementeve të kapitalit (pasurisë/aseteve) .
- 105.** Përjashtimet nuk zbatohen në rastet e strukturave tipike të fondeve të investimit/institucioneve financiare. Në bazë të objektit të tyre, këto fonde zakonisht nuk kanë të bëjnë vetëm në ushtrimin formal të të drejtave të votës, por marrin vendime për emërimin e drejtuesve dhe të anëtarëve të organeve kontrolluese të ndërmarrjeve madje edhe ristrukturimit të tyre. Kjo nuk do të ishte në përputhje me kriterin se: ndërmarrjet përfutuese nuk ushtrojnë të drejtat e votës për të vendosur sjelljen konkurruese të ndërmarrjes tjetër.
- 106.** Mund të shtrohet pyetja nëse një operacion për shpëtimin e një ndërmarrje para ose pas procesit të paaftësisë paguese mund të konsiderohet si përqendrim. Një operacion i këtij lloji normalisht përfshin edhe konvertimin e borxhit ekzistues dhe transferimin e tij tek një shoqëri e re, operacion nëpërmjet të cilit një partneritet bankash mund të përftojë kontrollin e përbashkët të shoqërisë në fjalë. Nëse një operacion i tillë përmbush kriteret e kontrollit të përbashkët si të shpjeguara më lart, normalisht do të konsiderohet një përqendrim. Edhe pse qëllimi kryesor i bankave është ristrukturimi financiar i ndërmarrjes në fjalë me qëllim ri-shitjen e saj, përjashtimi normalisht nuk zbatohet për këtë

operacion. Në mënyrë të përafërt mesa u tha për fondet e investimit, programi i ristrukturimit kërkon në parim që bankat kontrolluese të vendosin sjelljen strategjike tregtare të ndërmarrjes objekt i shpëtimit. Gjithashtu, normalisht është e pamundur të mendosh të transformosh një shoqëri në një shoqëri të shëndetshme dhe ta shesësh atë brenda periudhës së lejuar prej një viti. Për më tepër, periudha e kohës së nevojshme për të arritur këtë qëllim mund të jetë kaq e pasigurt sa e bën të vështirë dhënien e një shtyrje afati për shitjen.

## VI. Braktisja e një përqendrimi

107. Një përqendrim pushon së ekzistuari nëse ndërmarrjet në fjalë braktisin përqendrimin. Në këtë drejtim, parashikohet një dispozitë mbi mbylljen e procedurave të kontrollit të përqendrimëve pa një vendim përfundimtar pas nisjes së një procedure nga Autoriteti. Kjo do të thotë se “Të gjitha procedurat mbyllen me një vendim përveç kur ndërmarrjet nuk tregojnë, në mënyrë bindëse për Autoritetin, që të kenë braktisur përqendrimin”. Këto kushte nuk zbatohen para fillimit të procedurës së kontrollit.
108. Si parim i përgjithshëm, kushtet për të vërtetuar që një përqendrim është braktisur duhet të kenë forma juridike, intensitet etj, ndaj aktit fillestar i cili është konsideruar si i mjaftueshëm për ta bërë përqendrimin objekt njoftimi. Kur gjatë procedurës, palët kalojnë nga akti fillestar në përforcim të lidhjeve të tyre kontraktuale, p.sh përmbyllin një marrëveshje detyruese pasi transaksioni është njoftuar në bazë të një vendimi *asambleje/letter of intention* (qëllimi në besim të mirë), kushtet të cilat kërkohen për të provuar braktisjen e përqendrimin, duhet të përputhen edhe me natyrën e këtij akti.
109. Në linjë me këtë parim, në rast të realizimit të një përqendrimi para vendimit të Komisionit, duhet të provohet rivënia/rikthimi i gjendjes së mëparshme/*quo ante*. Tërheqja e thjeshtë e njoftimit nuk konsiderohet si provë e mjaftueshme për të vërtetuar se përqendrimi është braktisur. Në mënyrë analoge ndryshime minimale të një përqendrimi të cilat nuk influencojnë në ndryshimin e kontrollit ose në cilësinë e këtij ndryshimi nuk mund të konsiderohen si braktisje e përqendrimin fillestar.
- Marrëveshje detyruese: do të duhet prova e anulimit **ligjërisht detyruese** të marrëveshjes në formën e parashikuar në marrëveshjen fillestare (ose zakonisht kërkohet një dokument i nënshkruar nga të gjitha palët). Shprehja e qëllimit për të anuluar marrëveshjen, ose për të mos realizuar përqendrimin e njoftuar, si edhe deklaratat unilaterale (të njëanshme) prej palëve nuk do të konsiderohen të mjaftueshme.
  - Qëllimi/synimi në *mirëbesim* për të përmbyllur një marrëveshje: në rastin e një vendimi *asambleje/ letter of intention* ose të një memorandum bashkëpunimi të cilat pasqyrojnë këtë synim në *mirëbesim*, do të kërkohen dokumente, të cilat provojnë se kjo bazë për synimin në *mirëbesim* nuk ekziston më dhe është anuluar. Për sa i përket formave të tjera të mundshme për të treguar synimin në *mirëbesim*, braktisja duhet të anulohet këtë synim në *mirëbesim* dhe të përputhet në intensitet dhe formë me shprehjen fillestare të synimit.
  - Njoftimi i një oferte për blerje publike ose të synimit për të nisur një ofertë publike: do të kërkohet një njoftim publik për të ndërprerë procedurën e ofertës ose të heqjes dorë nga synimi i ofertës publike. Kushtet dhe përmbajtja publike e këtij njoftimi duhet të jenë të ngjashëm me njoftimin fillestar.

- Përqendrimet e realizuara: atëherë kur një përqendrim është realizuar para vendimit të Komisionit, palët duhet të provojnë se është rikthyer gjendja e mëparshme para se të aktualizojë përqendrimi.

Palët duhet të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm në një kohë të shkurtër për të respektuar kushtet e mësipërme.

## **VII. Ndryshimi i një operacioni pas vendimit të autorizimit të Komisionit**

- 110.** Në disa raste, palët mund të kërkojnë që të mos realizojnë përqendrimin në formën e parashikuar pas autorizimit përkatës nga Komisioni. Pra lind pyetja nëse vendimi i autorizimit të përqendrimin të Komisionit zbatohet edhe për strukturën e ndryshuar të transaksionit.
- 111.** Në vijë të përgjithshme, nëse para realizimit të përqendrimin të autorizuar, transaksioni ndryshon natyrë dhe në vend të përfuturit të kontrollit, bëhet një bashkim ose e kundërta, ndryshimi i natyrës së transaksionit përbën një përqendrim të ndryshëm dhe në këtë rast është e nevojshme një njoftim i ri. Megjithatë ndryshime më pak të rëndësishme të transaksionit, p.sh ndryshime minimale në përqindjet e zotërimit aksionar të cilat nuk ndikojnë në ndryshimin e kontrollit ose në cilësinë e tij, ndryshime të çmimit të ofertës në rastin e ofertave publike për përfutimin ose ndryshime në strukturën e ndërmarrjes nëpërmjet të cilit është kryer operacioni pa efekte për situatën e kontrollit, mund të konsiderohen të mbuluara nga vendimi i autorizimit të përqendrimin të Komisionit.

### **Pragjet /Kufiri i xhiros**

- 112.** Përveç kushteve të përmendura më sipër, një element i rëndësishëm në vlerësimin e përqendrimeve është edhe kufiri i xhiros që duhet të plotësojnë ndërmarrjet në mënyrë që të jenë objekt shqyrtimi nga Autoriteti. Xhiroja përdoret si përfaqësuese e burimeve ekonomike të cilat bashkohen në një transaksion përqendrimi dhe është ndarë gjeografikisht në mënyrë që të pasurojë shpërndarjen gjeografike të këtyre burimeve.
- 113.** Neni 12 parashikon dy pragje xhiroje për të vendosur nëse transaksioni duhet njoftuar apo jo. Në këtë nen parashikohet xhiroja në nivel kombëtar dhe në nivel ndërkombëtar.
- 114.** Kufiri i xhiros llogaritet për të përcaktuar nëse një përqendrim duhet njoftuar apo jo dhe nuk shërben për të vlerësuar as pozicionin e tregut komercial të palëve pjesëmarrëse në përqendrim as ndikimin e transaksionit: ato përfshijnë xhiron që vjen prej të gjithë sektorëve të aktivitetit të palëve, pra burimet që janë vënë në dispozicion në të, dhe jo vetëm xhiron dhe burimet e drejtpërdrejta të përqendrimin në fjalë. Pragu/kufiri i xhiros është tërësisht sasior, bazohet vetëm në të ardhurat, xhiron dhe jo në përqindjen e tregut ose në kritere të tjera; qëllimi i tyre është ai i ofrimit të një mekanizmi të thjeshtë dhe objektiv, të përdorimit të thjeshtë në shoqëritë pjesëmarrëse në përqendrim për të verifikuar nëse transaksioni është objekt njoftimi.

**115.** Qëllimi i nenit 15, 16 dhe 17 të ligjit është ai i përcaktimit të mënyrës së llogaritjes së xhiros në mënyrë që të garantojë arritjen e shifrave të cilat përbëjnë një përfaqësim sa më afër realitetit ekonomik.

## **II. Koncepti i ndërmarrjes pjesëmarrëse**

1. Konsiderata të përgjithshme

**116.** Palët pjesëmarrëse janë ato, të cilat realizojnë një përqendrim, një bashkim ose përfitim kontrolli. Xhiroja individuale dhe e përbashkët e këtyre ndërmarrjeve do të jetë kushti themelor për të përcaktuar nëse janë përmbushur kushtet e pragjeve.

**117.** Pasi janë përcaktuar ndërmarrjet pjesëmarrëse në një transaksion, xhiroja e tyre do të llogaritet në bazë të rregullave të përcaktuara në nenin 15, 16 dhe 17 të ligjit. Këto nene parashikojnë kriteret për të përcaktuar ndërmarrjet, xhiroja e të cilave mund të bashkohet me atë të ndërmarrjes pjesëmarrëse në bazë të lidhjeve direkte apo indirekte me këtë ndërmarrje. Qëllimi është për të vendosur rregulla konkrete të cilat në tërësi mund të lejojnë të zbatohet koncepti i “grupit” për qëllimin e llogaritjes së pragut të xhiros. Koncepti i “grupit” do të përdoret në seksionet pasardhëse ekskluzivisht vetëm për t’iu referuar një grupi/tërësi ndërmarrjesh.

**118.** Është e rëndësishme që mos të ngatërrohet koncepti i “ndërmarrjes pjesëmarrëse”. Midis koncepteve të përfshira janë edhe ato të palëve njoftuese, palëve të tjera të interesuara, palëve të treta të cilave mund tu vihen kushte apo sanksione për mospagesë së bashku me të drejtat dhe detyrimet përkatëse.

### **Shkrirjet/ Bashkimi**

Në rastin e një bashkimi, ndërmarrje pjesëmarrëse janë të gjitha ato të cilat marrin pjesë në bashkim.

### **Përfitimi i kontrollit**

**119.** Në raste të tjera është koncepti i “përfitimit të kontrollit” që përcakton se kush janë ndërmarrjet pjesëmarrëse. Për sa i përket se kush operon/vë në jetë përfitim, mund të jetë një ose më shumë ndërmarrje të cilat përftojnë kontrollin e vetëm apo të përbashkët. Objekt i përfitimit mund të jetë një ose disa ndërmarrje, një pjesë e tyre apo në tërësi. Në përgjithësi secila prej këtyre ndërmarrjeve, është një ndërmarrje pjesëmarrëse në kuptim të ligjit.

#### *Përfitim i kontrollit të vetëm/ ekskluziv*

**120.** Përfitimi i kontrollit të vetëm/ ekskluziv të një ndërmarrje në tërësi është rasti më i drejtpërdrejtë i përfitimit të kontrollit. Ndërmarrje pjesëmarrëse janë shoqëritë përfutuese dhe ndërmarrjet ose aktivitetet/ aksionet e përfutuar.



**121.** Kur ndërmarrja objekt i përfutimit përfutohet nga një grup nëpërmjet njëres prej shoqërive të kontrolluara prej tij, ndërmarrjet pjesëmarrëse janë ndërmarrja objekt i përfutimit/ target dhe ndërmarrja e kontrolluar përfutuese, atëherë kur kjo nuk është thjesht një mjet përfutimi. Megjithatë, edhe pse ndërmarrja e kontrolluar është normalisht ndërmarrja pjesëmarrëse për qëllimin e llogaritjes së xhiros, në llogaritjen e kufirit/ pragut të xhiros do të përfshihen edhe të gjitha ndërmarrjet me të cilat ndërmarrja pjesëmarrëse është e lidhur. Për këtë qëllim, grupi konsiderohet si një unitet ekonomik dhe ndërmarrjet të cilat i përkasin këtij grupi nuk mund të konsiderohen si ndërmarrje pjesëmarrëse të veçanta për të përcaktuar kompetencën për të njoftuar. Njoftimi mund të bëhet si nga ndërmarrja e kontrolluar gjithashtu edhe nga ndërmarrjet mëma.

*Përfutimi i pjesëve të një ndërmarrje dhe operacione të ndara në faza*

**122.** Përqendrimi mund të realizohet ndërmjet përfutimit të një pjese të një ose më shumë ndërmarrjesh, dhe në këtë rast llogaritet vetëm xhiroja që i takon vetëm palëve që janë objekt i transaksionit. Ndikimi që do të ketë transaksioni në treg, do të varet vetëm nga kombinimi i burimeve ekonomike dhe financiare objekt i transaksionit dhe ato të përfutuesit, dhe jo nga aktivitetet që i mbeten shitësit. Në këtë rast ndërmarrjet pjesëmarrëse janë ndërmarrja përfutuese dhe pjesët e përfutuara të ndërmarrjes objekt i përfutimit, por pjesët e tjera të shitësit nuk llogariten.

**123.** Transaksioni mund të jetë i ndarë në disa faza: për marrëveshjet që mbyllen në një kohë të dytë pas disa marrëveshjeve paraprirëse. Përqendrimet e mëparshme (brenda një periudhe prej 2 vjetësh) midis palëve të njëjta janë subjekt i detyrimit për (ri)njoftim së bashku me transaksionin më të fundit, me kusht që ky të përbëjë një përqendrim, atëherë kur pragjet janë arritur për njërin ose disa nga transaksionet, të marra veç e veç ose së bashku. Në një rast të tillë, ndërmarrjet pjesëmarrëse janë përfutuesja/estet dhe pjesët e ndryshme të përfutuara/blera të ndërmarrjes objekt i përfutimit **tw marra si njw e twrw.**

*Kalimi nga kontrolli i përbashkët në kontroll të vetëm/ ekskluziv*

**124.** Në rastin e përfutimit të kontrollit me anë të kalimit nga kontrolli i përbashkët në atë të vetëm/ekskluziv, një aksionar blen kuotat që i përkisnin më parë aksionarit tjetër ose aksionarëve të tjerë. Në këtë situatë, ndërmarrjet pjesëmarrëse janë aksionari blerës/përfutues dhe ndërmarrja e përbashkët. Si çdo shitës tjetër, aksionari “dalës” nuk është ndërmarrje pjesëmarrëse.

*Përfutim i kontrollit të përbashkët*

**125.** Në rastin e përfutimit të kontrollit të përbashkët të një ndërmarrjeje të re, ndërmarrja pjesëmarrëse është secila prej ndërmarrjeve që përfuton kontrollin e ndërmarrjes së re së përbashkët (e cila nuk ekziston akoma dhe për këtë nuk mund të konsiderohet si

ndërmarrje pjesëmarrëse, dhe për më tepër nuk ka akoma një xhiro të vetën). I njëjti rregull zbatohet edhe kur një ndërmarrje sjell një ndërmarrje të kontrolluar më parë ose një aktivitet (mbi të cilat ushtronte më parë vetëm kontrollin ekskluziv) tek ndërmarrja e përbashkët e sapo themeluar. Në këto rrethana, secila prej ndërmarrjeve që ushtrjnë kontrollin e përbashkët konsiderohet ndërmarrje pjesëmarrëse, ndërsa nuk janë të tilla ndërmarrjet ose aktivitetet e transferuara në ndërmarrjen e përbashkët, xhironja e të cilave hyn në xhiron e ndërmarrjes fillestare mëmë.

**126.** Situata është e ndryshme nëse ndërmarrjet përftojnë ex novo kontrollin e përbashkët të një ndërmarrje apo aktivitete të mëparshme. Në këtë rast ndërmarrja pjesëmarrëse është secila nga ndërmarrjet që përftojnë kontrollin e përbashkët, nga njëra anë, dhe ndërmarrja ose aktiviteti ekzistues i përftuar, nga ana tjetër.

**127.** Përftimi i një ndërmarrje e cila është në prag të një ndarje të aktiveve/ aseteve/ aksioneve, në rastin më të madh nuk konsiderohet si një përfitim kontrolli i përbashkët të të gjithë ndërmarrjes, por si një përfitim kontrolli të vetëm/ ekskluziv, nga ana e secilit prej blerësve përfundimtarë, të pjesëve përkatëse të ndërmarrjes objekt i operacionit. Në linjë me sa u tha për përfitim të vetëm/ ekskluziv, ndërmarrje pjesëmarrëse janë ndërmarrjet përfutuese dhe pjesët e përfutuara në secilën prej transaksioneve.

*Ndryshim i aseteve/ aksioneve/ pjesëmarrjes të kontrollit në rastin e kontrollit të përbashkët të një ndërmarrje të përbashkët ekzistuese*

**128.** Një përqendrim mund të jetë objekt i njoftimit, siç u sqarua më sipër, atëherë kur ka një ndryshim në cilësinë e kontrollit në një strukturë kontrolli të përbashkët, si pasojë e hyrjes së aksionarëve të rinj kontrollues, pavarësisht faktit nëse ata zëvendësojnë aksionarët kontrollues ekzistues.

**129.** Në rastin kur një apo më shumë aksionarë përftojnë kontrollin, nëpërmjet hyrjes në ndërmarrje ose zëvendësimit të një apo më shumë aksionarëve, në një situatë të kontrollit të përbashkët si para ashtu edhe pas transaksionit/ operacionit, ndërmarrjet pjesëmarrëse janë aksionarët (si ata ekzistues edhe të rinjtë) të cilët kanë kontrollin e përbashkët të vetë ndërmarrjes së përbashkët. Nga njëra anë, ashtu si për përfitim të kontrollit të përbashkët të një ndërmarrje ekzistuese, ndërmarrja e përbashkët mund të konsiderohet ndërmarrje pjesëmarrëse palë, pasi është ndërmarrje ekzistuese që më parë. Nga ana tjetër, sic u përcaktua më sipër, hyrja e një aksionari të ri nuk përbën në vetvete/ *per se* vetëm një përfitim të ri kontrolli, por përcakton edhe një ndryshim të cilësisë të kontrollit për aksionarët kontrollues të mbetur: cilësia e kontrollit të ndërmarrjes së përbashkët përcaktohet në fakt nga identiteti dhe përbërja e aksionarëve kontrollues dhe pra edhe të lidhjeve ekzistuese ndërmjet tyre. Ndërmarrja e përbashkët konsiderohet si një kombinim i burimeve ekonomike të ndërmarrjeve mëma, plus edhe ato të ndërmarrjes së përbashkët nëse ajo gjeneron të ardhura/ xhiro në treg. Për këto arsye, aksionarët kontrollues të cilët hyjnë në ndërmarrje, janë ndërmarrje pjesëmarrëse së bashku me aksionarët e tjerë kontrollues të cilët mbeten. Meqenëse ndryshon cilësia e kontrollit, pretendohet se të gjithë aksionarët realizojnë përfitim kontrolli.

**130.** Të gjitha përfitimet e kontrollit të përbashkët duhet të njoftohen në mënyrë të përbashkët nga ndërmarrjet përfutuese të këtij kontrolli, aksionarët e rinj dhe ekzistues, të cilët duhet të njoftojnë bashkërisht përqendrimet që shkaktojnë këto ndryshime të situatave të kontrollit të përbashkët.

*Përfitimi i kontrollit nga një sipërmarrje e përbashkët*

**131.** Kur një sipërmarrje e përbashkët/ joint venture përfiton kontrollin e një shoqërie, lind pyetja nëse sipërmarrja e përbashkët konsiderohet ndërmarrje pjesëmarrëse (xhiroja e së cilës do të përfshihet në atë të ndërmarrjeve mëma) apo nëse çdonjëra nga ndërmarrjet mëmë do të konsiderohet veçmas si ndërmarrje pjesëmarrëse. Kjo çështje mund të jetë vendimtare për të përcaktuar kompetencën e Autoritetit pwr efekt tw xhiros. Nëse parimisht ndërmarrja pjesëmarrëse dhe sipërmarrja e përbashkët/joint venture si pjesëmarrëse direkte në përfitim të kontrollit, mund të jenë në rrethanat që ndërmarrjet krijojnë “kuti bosh” dhe ndërmarrjet mëma konsiderohen individualisht si ndërmarrje pjesëmarrëse. Në këto lloj situatash, për të përcaktuar se cilat janë ndërmarrjet pjesëmarrëse, do të merret parasysh konteksti ekonomik real i operacionit/transaksionit.

**132.** Kur përfitimi është realizuar nga një sipërmarrje e përbashkët/ joint venture me funksion të plotë, me karakteristikat e sipërpërmendura, e cila vepron tashmë në të njëjtin treg, do të konsiderohet ndërmarrje pjesëmarrëse, sipërmarrja e përbashkët/ joint venture dhe ndërmarrja objekt i transaksionit (dhe jo ndërmarrjet mëma të sipërmarrjes së përbashkët/ joint venture).

**133.** Në të kundërt, kur sipërmarrja e përbashkët/ joint venture mund të konsiderohet thjesht si mjet për një përfitim nga ana e ndërmarrjeve mëma, do të konsiderohen si ndërmarrje pjesëmarrëse, secila prej ndërmarrjeve mëma (në vend të sipërmarrjes së përbashkët), ashtu edhe ndërmarrja objekt i përfimit. Kjo ndodh në veçanti në rastet kur ndërmarrja e përbashkët/ joint venture është themeluar posaçërisht për të përfutuar ndërmarrjen objekt i transaksionit ose kur nuk ka nisur akoma të operojë/veprojë, kur një sipërmarrje e përbashkët ekzistuese nuk ka karakter me funksion të plotë siç është referuar më sipër ose kur sipërmarrja e përbashkët/ joint venture është një konsorcium ndërmarrjesh. I njëjti arsyetim vlen edhe kur ka elementë, të cilat lënë të kuptosh se ndërmarrjet mëma janë mëkëmbësit/krijueset reale të transaksionit. Këto elementë mund të jenë një përfshirje e madhe nga vetë kompanitë mëma në iniciativën, në organizimin apo financimin e operacionit. Në këtë rast ndërmarrjet mëma konsiderohen si ndërmarrje pjesëmarrëse.

*Ndarja e sipërmarrjeve të përbashkëta/ joint ventures dhe shkëmbimi i aktiveve/aksioneve/aseteve*

**134.** Kur dy (ose më shumë ndërmarrje) ndajnë sipërmarrjen e përbashkët/ joint venture dhe aktivet/ asetet (që përbëjnë aktivitete të veçantë) ndërmjet tyre, normalisht kjo do të konsiderohet sikur ka disa përfitme të kontrollit, siç është ilustruar në pikën 30. P.sh. ndërmarrjet A dhe B themelojnë një sipërmarrje të përbashkët dhe më pas e ndajnë veçmas

me një ndarje të re të aktiveve. Ndarja e sipërmarrjes së përbashkët i lë vend kalimit nga kontrolli i përbashkët mbi të gjitha aktivet e sipërmarrjes së përbashkët, kontrollit të vetëm/ ekskluziv të aktiveve/ asetëve të ndara nga secila prej ndërmarrjeve përftuese.

**135.**Për çdo operacion ndarje, për përftimin e kontrollit të vetëm/ ekskluziv, ndërmarrjet pjesëmarrëse janë, nga njëra anë, pala përftuese dhe nga ana tjetër, aktivet që kjo ndërmarrje përfton.

**136.**E përafërt me situatën e ndarjes është ajo në të cilën dy (ose më shumë) ndërmarrje shkëmbejnë më njëra tjetrën aktivet, të cilët përbëjnë një aktivitetet/ biznes të veçantë për çdo ndërmarrje. Në këtë rast, secili përftim i kontrollit konsiderohet një përftim i pavarur i kontrollit të vetëm/ ekskluziv. Për secilën nga operacionet, ndërmarrjet pjesëmarrëse janë ndërmarrjet përftuese dhe ndërmarrjet ose aktivet/ asetet e përftuara/ blera.

#### *Përftimi i kontrollit nga persona fizik*

**137.**Kontrolli mund të përftohet edhe nga persona fizikë, nëse vetë personat zhvillojnë aktivitete të tjera ekonomike (dhe janë të klasifikuar si ndërmarrje ekonomike) ose nëse ata kontrollojnë një ose më shumë ndërmarrje të tjera ekonomike. Në këtë situatë, ndërmarrjet pjesëmarrëse janë ndërmarrjet objekt i përftimit/ blerjes dhe vetë blerësi/ përftuesi individual (xhiroja e ndërmarrjes/eve të kontrolluara nga ky përftues përfshihen në llogaritjen e xhiros së personit fizik në të njëjtën masë sa ato përmbushin dispozitat e nenit 15 dhe 16 të ligjit)

**138.**Përftimi i kontrollit të një ndërmarrje nga drejtuesit/ manaxherët e saj është edhe ai një përftim nga ana e personave fizikë si në pikën 137. Megjithatë për të përfaqësuar më mirë interesat e veta, drejtuesit e ndërmarrjes mund të themelojnë një shoqëri “mjet” e cila i lejon të flasin në një zë të vetëm dhe të lehtësojë procesin e vendimmarrjes. Kjo shoqëri mjet mundet por nuk duhet të jetë patjetër ndërmarrje pjesëmarrëse. Edhe në këtë rast zbatohen udhëzimet e përgjithshme nga pikat 132 deri 134 mbi përftimin e kontrollit nga ana e një sipërmarrje të përbashkët/ joint venture.

#### *Përftimi i kontrollit nga ndërmarrje me pronësi shtetërore*

**139.**Siç u shpjegua, një operacion bashkimi/ shkrirje ose përftimi të kontrollit ndërmjet dy ndërmarrjeve në pronësi të të njëjtit Shtet (ose të të njëjtit ent/ organ publik) mund të përbëjë një përqendrim nëse ndërmarrjet përbënin aktivitete të ndryshme ekonomike, të pajisura me fuqi vendimmarrje autonome/ të pavarur. Në këtë rast, të dyja ndërmarrjet janë ndërmarrje pjesëmarrëse edhe pse janë në pronësi të të njëjtit Shtet.

## I. Të dhënat e nevojshme për të përcaktuar kompetencën

140. Në kuptim të ligjit, për njoftimin e një përqëndrimi duhet që të kishite një përfundim të një marrëveshje përfundimtare ose shpallje të një oferte publike ose përfitim të një pjesëmarrje kontrolluese - dhe palët ishin të detyruara të njoftonin (pra 1 javë pas ngjarjes e cila përcaktonte detyrimin për njoftim). Me amendimet e Ligjit Nr. 9121 “ Pwr Mbrojtejn e Konkurrencws”, datw 28.07.2003, nw vitin 2010 njoftimi i përqëndrimit depozitohet pranw Autoritetit tw Konkurrencws brenda 30 ditwve nga lidhja e marrëveshjes pwr bashkim, pwr përfitim kontrolli ose pwr krijimn e njw ndërmarrje tw pwrbashkwit si deh nga publikimi i ofertës publike pwr blerje ose shkëmbim.
141. Ndërmarrjet pjesëmarrëse, në bazë të rregullores Pas momentit të njoftimit, Autoriteti përcakton nëse kemi të bëjmë me një përqëndrim apo jo. Në bazë të ligjit, përqëndrimet duhet të njoftohen pas përfundimit të marrëveshjes, komunikimit/njoftimit të ofertës publike ose përfimit të kuotës kontrolluese. Datat e këtyre ngjarjeve janë vendimtare.
142. Data për të vendosur mbi një përqëndrim është ajo e përfundimit të marrëveshjes juridikisht detyruese, e njoftimit të një oferte publike apo e përfimit të pjesëmarrjes kontrolluese ose ajo e njoftimit të parë, cilado datë më e hershmja.

## II. Xhiro

### 1. Koncepti i xhiros

143. Xhiro, përfshin “të ardhurat që rezultojnë nga shitja e produkteve dhe nga ofrimi i shërbimeve”. Në përgjithësi këto të ardhura shfaqen në llogaritë e shoqërive/ ndërmarrjeve poshtë zërit “shitje”. Në rastin e produkteve, xhiroja mund të identifikohet pa vështirësi: në fakt bëhet fjalë për të mbuluar çdo shitje pronësie në kuadrin e aktivitetit tregtar të ndërmarrjes/ duke identifikuar çdo veprim/ akt tregtar që përfshin një transferim pronësie.

Metodologjia e llogaritjes së xhiros i zbatueshëm për shërbimet nuk është përgjithësisht i ndryshëm nga ai i përdorur për produktet: Autoriteti merr në konsideratë të ardhurat totale nga shitjet/ sasinë totale të shitjeve. Megjithatë, llogaritja e të ardhurave që vijnë nga ofrimi i shërbimeve mund të jetë më i ndërlikuar pasi kjo varet nga natyra specifike e shërbimit të ofruar dhe nga rregullat juridike dhe ekonomike të sektorit në fjalë. Kur një ndërmarrje i ofron klientit të gjithë shërbimin direkt, xhiroja e ndërmarrjes pjesëmarrëse do të konsistojë në shumën totale të shitjeve nga ofrimi i shërbimeve në vitin e fundit financiar.

144. Në fusha të tjera/Me fjalë të tjera, ky parim i përgjithshëm mund tu përshtatet kushteve specifike të shërbimit të ofruar. Në disa sektorë të aktivitetit (si p.sh paketa pushimesh, publicitet/ reklamim etj) shërbimi mund të shitet nëpërmjet ndërmjetësve. Edhe pse ndërmjetësi ia faturon/ngarkon të gjitha të ardhurat klientit përfundimtar, xhiroja e ndërmarrjes e cila vepron si ndërmjetës, konsiston vetëm në të ardhurat e komisionit të saj. Për paketat e pushimeve, i tërë çmimi/ e tërë sasia i/e paguar nga klienti përfundimtar shkon për operatorin turistik, i cili e përdor agjencinë e udhëtimit si rrjet

distribucioni/shpërndarje. Në rastin e reklamës, pretendohet që vetëm të ardhurat e marra (pa komision) përbëjnë xhiron e kanalit televiziv ose të revistës, pasi agjencitë publicitare, si ndërmjetës, nuk përbëjnë kanalën e shpërndarjes për shitësit e hapësirave publicitare por janë të zgjedhura nga klientët, si p.sh nga ndërmarrjet që duan të blejnë një hapësirë publicitare (reklamë).

**145.** Shembujt e përmendur tregojnë se meqenëse ka ndryshim në shërbime, mund të ketë shumë situata të ndryshme dhe se lidhjet juridike dhe ekonomike themelore që rrjedhin duhet të analizohen me kujdes. Në mënyrë të përafërt/ ngjashme, mund të ketë situata specifike për llogaritjen e xhiros në sektorin e kreditit, të shërbimeve financiare dhe të sigurimeve. Këto çështje trajtohen në seksionin VI.

## **2. Aktivitetet e zakonshme**

**146.** Të ardhurat për tu marrë në konsideratë për llogaritjen e xhiros duhet të korrespondojnë me “aktivitetet e zakonshme” të ndërmarrjeve pjesëmarrëse. Në fakt, bëhet fjalë për të ardhurat e realizuara nga shitja e produkteve ose ofrimi i shërbimeve gjatë zhvillimit normal të aktivitetit. Zakonisht, përjashtohen të ardhurat e regjistruara në llogaritë e ndërmarrjes nën zërat “të ardhurat financiare” ose “të ardhurat e jashtëzakonshme”. E ardhur e jashtëzakonshme mund të jetë ajo me prejardhje nga shitja e aktivitetëve apo e aktiveve/aseteve fikse. Megjithatë, llogaritë e ndërmarrjes nuk regjistrojnë patjetër me domosdoshmëri të ardhurat/hyrjet me prejardhje nga aktiviteti i zakonshëm në mënyrën e kërkuar për qëllimin e llogaritjes së xhiros në bazë të ligjit. Në disa raste, mund të jetë e domosdoshme për të adoptuar/aplikuar klasifikimin e zërave siç kërkon ligji.

**147.** Të ardhurat nuk duhet të vijnë patjetër nga klienti/përfituesi i produkteve apo i shërbimeve. Përsa i përket ndihmave të dhëna ndërmarrjeve nga entet publike, çdo ndihmë duhet të hyjë në llogaritjen e xhiros, nëse vetë ndërmarrja është përfutuese e ndihmës dhe kjo e fundit është e lidhur drejtpërdrejtë me shitjen e produkteve apo ofrimin e shërbimeve nga ndërmarrja. Ndihma është pra një e ardhur e ndërmarrjes që rrjedh nga shitja e produkteve ose nga ofrimi i shërbimeve si shtesë e çmimit të paguar nga konsumatori.

**148.** Kanë lindur pyetje specifike për llogaritjen e xhiros të një njësie tregtare/ekonomike, që në të shkuarën kishte vetëm të ardhura të brendshme. Kjo mund të zbatohet në veçanti për transaksionet të cilat sjellin *burime nga jashtë/ outsourcing* të shërbimeve nëpërmjet transferimit të një njësie ekonomike. Nëse një transaksion i këtij lloji përbën një përqendrim në bazë të arsytimit të bërë në pikat 21 dhe në vijim të këtij udhëzimi, xhiroja duhet të llogaritet normalisht mbi bazën e xhiros së brendshme të mëparshme ose të çmimeve të kuotuar publikisht/ listuara në bursë kur këto çmime ekzistojnë (p.sh në industrinë e karburanteve). Nëse xhiroja e brendshme e mëparshme nuk korrespondon me vlerësimin e tregut të aktivitetëve në fjalë (dhe gjithashtu edhe xhiros së ardhshme në treg), të ardhurat e parashikuara mbi bazën e një marrëveshjeje me ndërmarrjen mëmë të mëparshme mund të jenë një zëvendësues i përshtatshëm.

## **3. Xhiroja “neto”**

**149.** Xhiroja e cila merret në konsideratë është xhiroja “neto”, pra xhiros i hiqen (minus) një numër elementësh të përcaktuar në ligj. Qëllimi është pastrimi i xhiros në mënyrë që të pasqyrojë peshën reale ekonomike të ndërmarrjes.

**a. Zbritja e tarifës së uljeve, tatimeve dhe taksave**

**150.** Në llogaritjen e xhiros duhet që të zbatohet “zbritja e tarifës së uljeve të lidhura me shitjet si edhe të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimeve të tjera të lidhura drejtpërdrejt me xhiron”. Për “tarifë e uljes mbi shitjet” nënkuptohet tërësia e uljeve dhe e pakësimit të koordinuar të dhëna/akorduara nga ndërmarrjet për klientët dhe që influencojnë direkt mbi të ardhurat/ fitimin nga shitjet.

**151.** Pas zbritjes së taksave dhe tatimeve, zbritet TVSh dhe “tatime të tjera të lidhura me xhiron”. Koncepti “tatime të tjera të lidhura me xhiron” i referohet tatimeve indirekte pasi këto janë të lidhura drejtpërdrejtë me xhiron si p.sh. akciza mbi pijet alkoolike apo mbi cigaret.

**a. Trajtimi i xhiros së “brendshme”**

**152.** “Xhiroja totale e një ndërmarrje pjesëmarrëse nuk përfshin transaksionet e ndodhura ndërmjet ndërmarrjeve”, ose brenda grupit të cilit i përket ndërmarrja pjesëmarrëse. Bëhet fjalë për të përjashtuar produktin e lidhjeve tregtare brenda grupit me qëllim për të marrë parasysh peshën reale ekonomike të secilit entitet nën formën e xhiros së tregut. “Të ardhurat” që merren parasysh reflektojnë ekskluzivisht vetëm tërësinë e transaksioneve të realizuara ndërmjet grupit të ndërmarrjeve, nga njëra anë, dhe të tretëve, nga ana tjetër.

**153.** Në llogaritjen e xhiros duhet të zbatohet parimi sipas së cilit duhet të evitohet numërimi i dyfishtë në situatën kur dy ose më shumë ndërmarrje pjesëmarrëse në një përqendrim mbajnë së bashku në një ndërmarrje tjetër të drejtat dhe kompetencat. Sipas kësaj dispozite përjashtohet xhiroja që rezulton nga shitja e produkteve ose nga ofrimi i shërbimeve të kryera ndërmjet ndërmarrjes së përbashkët dhe secilës prej ndërmarrjeve pjesëmarrëse ose çdo ndërmarrje tjetër e lidhur me njërin nga ato. Për sa i përket ndërmarrjeve të përbashkëta, të themeluara ndërmjet ndërmarrjeve pjesëmarrëse dhe të ndërmarrjeve të treta, në masën në të cilën xhiroja e tyre merret në konsideratë, siç është përcaktuar në pikën 166, xhiroja e gjeneruar nga ndërmarrja e përbashkët dhe ndërmarrjes pjesëmarrëse (si edhe ndërmarrjet e lidhura me ndërmarrjen pjesëmarrëse) nuk merret në konsideratë.

## **Llogaritja e xhiros dhe llogaritë financiare**

### **4.1 Metodologjia e përgjithshme**

**154.** Komisioni kërkon të bazohet në shifrat më të sakta dhe të besueshme që ka në dispozicion. Në përgjithësi, duhet të merren në konsideratë llogaritë që i referohen vitit

ushtrimor financiar më të afërt me operacionin dhe që janë të certifikuara/audituar sipas normave që i zbatohen ndërmarrjes në fjalë dhe që janë të detyrueshme për vitin ushtrimor financiar përkatës. Vlerat e certifikuara/audituar mund të korrigjohen vetëm nëse kjo është e nevojshme për të respektuar dispozitat e Ligjit dhe specifikisht në rastet e ilustruara më poshtë.

**155.** Zakonisht preferohet të mos përdoren llogaritë e administrimit ose çdo lloj forme tjetër të llogarive provizore/të përkohshme, përveç në raste të veçanta. Në rastet ku përqendrimi realizohet në muajt e parë të vitit dhe nuk janë ende gati llogaritë e certifikuara /audituar për vitin ushtrimor të fundit, shifrat që merren në konsideratë janë ato të vitit ushtrimor të mëparshëm. Kur ka një ndryshim të konsiderueshëm midis llogarive të dy viteve ushtrimore, për shkak të ndryshimeve të rëndësishme dhe të përhershme në ndërmarrjen pjesëmarrëse, dhe në veçanti kur është miratuar nga këshilli administrues projekti përfundimtar i llogarive të vitit të fundit, mund të vendoset të merren në konsideratë këto të fundit.

#### **4.2 Korrigjimet e kryera pas datës së llogarive të fundit të certifikuara /audituar**

**156.** Përveç atyre që u theksuan në pikat e mëparshme, gjithmonë është i nevojshëm një korrigjim për të marrë parasysh ndryshimet e vazhdueshme në realitetin ekonomik të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, përfitimet apo shitjet e të cilave nuk pasqyrohen në llogaritë e certifikuara ose nuk janë të plota. Është e rëndësishme të kihet parasysh këto ndryshime për të identifikuar burimet reale, objekt i transaksionit/ përqendrimit dhe të pasqyrohet më mirë situata ekonomike e ndërmarrjeve pjesëmarrëse. Këto korrigjime kanë natyrë përzgjedhëse dhe nuk paragjykojnë parimin sipas së cilit duhet të kishte një mekanizëm të thjeshtë dhe objektiv për të vendosur/ përcaktuar kompetencën e Autoritetit, duke qenë se nuk kërkohet një rishikim total komplet i llogarive të certifikuara/ audituar. Në radhë të parë kjo vlen për përfitimet, për shitjet ose për mbylljen e pjesës së aktivitetit në një datë të mëvonshme se data e llogarive të certifikuara/ audituar. Një rast i tillë shfaqet kur një ndërmarrje përmbyll një transaksion që ka të bëjë me shitjen ose mbylljen e pjesës së aktivitetit të saj në çdo moment para datës të përcaktuar për të vendosur kompetencën (shih pikën 140) ose kur kjo shitje apo mbyllje e aktivitetit përbën një parakusht për operacionin. Në këtë rast xhiroja që i atribuohet kësaj pjesë të aktivitetit duhet të zbritet nga xhiroja e palës njoftuese e shënuar në llogaritë e fundit të certifikuara të saj. Nëse nënshkruhet një marrëveshje për shitjen e pjesës së aktivitetit, por shitja nuk është vërtetuar akoma (me fjalë të tjera nuk është kryer akoma ekzekutimi juridik dhe transferimi i titullit juridik përkatës i aksioneve ose aktiveve të blera/ përftuara), ndryshimi nuk merret parasysh, vetëm në rast se/ deri kur shitja është parakusht për operacionin/ transaksionin e njoftuar. Në të kundërt, xhiroja që i atribuohet aktivitetit, transaksioni i përfimit/ blerjes të së cilës është mbyllur më vonë se redaktimi/ korrigjimi i llogarive më të vonshme, por para datës së caktuar për të përcaktuar kompetencën, i shtohet xhiros së shoqërisë për qëllime të njoftimit.

**157.** Në radhë të dytë, mund të jetë e nevojshme korrigjimi edhe për përfitimet/ blerjet-shitjet ose mbylljen e pjesës së aktivitetit që realizohen në vazhdim të vitit financiar për të



cilin janë redaktuar/korigjuar llogaritë e audituara. Nëse përfitimet, shitjet ose mbylljet e pjesshme të aktivitetit që realizohen në vazhdim të vitit financiar, ndryshimet në burimet ekonomike mund të pasqyrohen në mënyrë të pjesshme në llogaritë e certifikuara/audituar të ndërmarrjes pjesëmarrëse. Meqenëse xhiroja e aktivitetit të përftuar, mund të futet në llogari vetëm nga momenti i përfimit të tyre, xhiroja e regjistruar mund të mos reflektojë xhiron vjetore totale të aktivitetit të përftuar. Në të kundërt, xhiroja e aktiviteteve të transferuara ose të mbyllura mund të përfshihet në llogaritë e audituara /certifikuara, deri në momentin e mbylljes apo transferimit efektiv. Në këto raste duhet të bëhen korrigjimet për të zbritur nga llogaritë, xhiron e vendosur nga aktivitetet e transferuara apo mbyllura deri në momentin e de-konsolidimit dhe të shtohet xhiroja që aktivitetet e përfthuara kanë gjeneruar gjatë vitit deri në momentin në të cilin janë konsoliduar në llogaritë. Për rrjedhojë, xhiroja e aktiviteteve të transferuara apo të mbyllura duhet të jetë e përjashtuar tërësisht dhe duhet të përfshihet në xhiron vjetore totale të aktiviteteve të përfthuara.

**158.** Faktorë të tjerë të cilët njëkohësisht mund të kenë ndikim mbi xhiron, si rënia e porosive ose ngadalësimi i procesit së prodhimit në periudhën e mëparshme/ para transaksionit, nuk do të përfshihen në llogaritjen e të ardhurave/ xhiros. Nuk do të procedohet në korrigjimin e llogarive përfundimtare për të pasur parasysh këta faktorë.

## **5. Shpërndarja e të ardhurave/ xhiros**

### **5.1 Identifikimi i ndërmarrjeve xhiroja e të cilave është marrë/ merret në konsideratë**

**159.** Kur një ndërmarrje pjesëmarrëse në përqendrim është pjesë e një grupi, nuk merret në konsideratë vetëm xhiroja e ndërmarrjes pjesëmarrëse por edhe ajo e ndërmarrjeve me të cilat ndërmarrja pjesëmarrëse ka lidhje të rëndësishme në aspektin e të drejtave dhe kompetencave sipas pikës 161, për të përcaktuar nëse ajo i përmbush pragjet/kufirin e xhiros. Qëllimi edhe në këtë rast është ai i konstatimit të volumit total të burimeve ekonomike që përfshihen me anë të transaksionit, pavarësisht faktit që aktivitetet ekonomike zhvillohen drejtpërsëdrejti nga ndërmarrja pjesëmarrëse apo zhvillohen indirekt me anë të ndërmarrjeve me të cilat ndërmarrja pjesëmarrëse ka lidhje.

**160.** Nëse një ndërmarrje pjesëmarrëse, në mënyrë direkte apo indirekte, ka lidhje me ndërmarrje të tjera, ato duhet të konsiderohen si pjesë përbërëse e grupit të saj për qëllime të përlllogaritjes së xhiros.


**161.** Xhiroja e një ndërmarrje pjesëmarrëse përbëhet nga shuma e xhirove të ndërmarrjeve si më poshtë :

- a) ndërmarrja pjesëmarrëse;
- b) ndërmarrjet në të cilat ndërmarrja pjesëmarrëse zotëron, direkt apo indirekt,
  - i. ose më shumë se gjysmën e kapitalit themeltar ose të kapitalit ushtrimor; ose
  - ii. fuqinë për të ushtruar më shumë se gjysmën e të drejtave të votës; ose
  - iii. fuqinë për të emëruar më shumë se gjysmën e anëtarëve të bordit mbikqyrës ose të asamblesë ose të organeve të tjera përfaqësuese të ndërmarrjes; ose

- iv. të drejtën për të administruar çështjet e ndërmarrjes;
- c) ndërmarrjet të cilat zotërojnë në një ndërmarrje pjesëmarrëse, të drejta apo fuqi të listuara në shkronjën b);
- d) ato në të cilat ose mbi të cilat një ndërmarrje e germës c) zotëron të drejta ose fuqi të përmendura në shkronjën b);
- e) ato ndërmarrje në të cilat një ose më shumë ndërmarrje në kuptim të shkronjave nga a) në d) zotërojnë së bashku të drejta dhe fuqi si në shkronjën b)”. .

**162.** Në këtë seksion mbi llogaritjen e xhiros, një ndërmarrje e cila zotëron në një ndërmarrje tjetër të drejta apo kompetenca përcaktohet si “ndërmarrje mëmë” e kësaj ndërmarrje, ndërsa ndërmarrja e dytë është “e kontrolluara” e së parës. Xhiroja e ndërmarrjes të përfshirë direkt në transaksion [shkronja a)] duhet pra të përfshijë ndërmarrjet e kontrolluara prej saj [shkronja b)], ndërmarrjet mëma [shkronja c)], ndërmarrjet e tjera të kontrolluara nga ndërmarrjet mëma [shkronja d)] dhe ndërmarrje të tjera potencialisht të kontrolluara bashkërisht nga dy ose më shumë ndërmarrje si në pikat a) deri në d) më sipër [shkronja e)].

**163.** Më poshtë është ofruar një prezantim grafik: Ndërmarrja pjesëmarrëse dhe grupi i saj:



- a. ndërmarrja pjesëmarrëse
- b. të kontrolluarat prej saj, ndërmarrjet të zotëruara bashkërisht me të tretë (b3) dhe të kontrolluarat nga këto të fundit (b1 dhe b2)
- c. ndërmarrjet e saj mëma dhe ndërmarrjet mëma të këtyre të fundit (c1)
- d. të tjera të kontrolluara nga shoqëritë mëma të shoqërisë pjesëmarrëse
- e. ndërmarrje të zotëruara bashkërisht nga dy (ose më shumë) shoqëri të grupit

*x. të tretë*

Përqindjet e treguara në grafik i referohen përqindjeve të të drejtave të votës të mbajtura/zotëruara nga shoqëria mëmë përkatëse.

**164.** Të drejtat dhe kompetencat, mund të identifikohen në mënyrë mjaft të drejtpërdrejtë pasi i referohen pragjeve sasiore. Këto pragje arrihen nëse ndërmarrja pjesëmarrëse zotëron më shumë se gjysmën e kapitalit themeltar ose të kapitalit ushtrimor të ndërmarrjeve të tjera, zotëron më shumë se gjysmën e të drejtave të votës, ose ka fuqinë ligjore për të emëruar më shumë se gjysmën e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe asamblesë në ndërmarrje të tjera. Megjithatë, pragjet arrihen nëse ndërmarrja pjesëmarrëse ka fuqinë *de facto* për të ushtruar më shumë se gjysmën e të drejtave të votës në asamblenë e aksionerëve ose për të emëruar më shumë se gjysmën e pjesëmarrësve të bordit drejtues ose të asamblesë në ndërmarrje të tjera.

**165.** E drejta për të manaxhuar punët e ndërmarrjes. Kjo lloj e drejte për të manaxhuar mund të ekzistojë në bazë të së drejtës tregtare (të shoqërive), në veçanti në bazë të kontratave organizuese si “Beherrschungsvertrag” e parashikuar nga ligji gjerman, në bazë të marrëveshjeve të qerasë së aktivitetit ose në bazë të strukturës organizuese për ortakun me përgjegjësi të pakufizuar në një **ndërmarrje/shoqëri komandite**. Megjithatë, e “drejta për të manaxhuar/ e manaxhimit” mund të jepet/atribuohet edhe për faktin se zotëron të drejta të votës (vetëm apo në kombinim me marrëveshje kontraktuale, si p.sh një marrëveshje midis aksionarëve) të cilat i lejojnë, mbi baza juridike të qëndrueshme, të cilat mund të vendosin mbi sjelljen strategjike të një ndërmarrje.

**166.** E drejta për të manaxhuar përfshin situata në të cilat ndërmarrja pjesëmarrëse ka të drejtën të drejtojë biznesin/ aktivitetin e ndërmarrjes së bashku me të tretët. Ndërmarrjet të cilat ushtrojnë kontrollin së bashku, kanë bashkarisht të drejtën e drejtimit të biznesit të ndërmarrjes së kontrolluar edhe pse secila prej tyre mund të ketë individualisht të drejta të tilla vetëm në kuptimin negativ, ose në formën e të drejtave të vetos. Për shembull, ndërmarrja (b3), e cila është e kontrolluar së bashku nga ndërmarrja/et (a) dhe nga një i tretë (‘x’), merret në konsideratë përderisa si “a” ashtu edhe “x” kanë të drejta vetoje në “b3” në bazë të pjesëmarrjes së tyre të barabartë në “b3” Në këtë rast do të merren në konsideratë vetëm ndërmarrjet e përbashkëta në të cilat ndërmarrja pjesëmarrëse dhe të tretat gëzojnë nën profilin juridik të drejta të cilat përcaktojnë një të drejtë të qartë administrimi/drejtimit. Ndërmarrjet e përbashkëta përfshihen sakaq vetëm në situatat në të cilat një ndërmarrje pjesëmarrëse dhe të tretët kanë një të drejtë drejtimit të përbashkët në bazë të një marrëveshje, p.sh. të një marrëveshje midis aksionarësh, ose në të cilin ndërmarrja pjesëmarrëse dhe të tretët kanë të drejta të barabarta të votës dhe kanë si rrjedhojë të drejtën për të emëruar një numër të barabartë të anëtarëve të organeve vendimmarrëse të ndërmarrjes së përbashkët.

**167.** Në mënyrë analoge, kur dy ose më shumë shoqëri kontrollojnë së bashku ndërmarrjen pjesëmarrëse, në kuptimin që është e nevojshme një marrëveshje e secilës prej tyre për të drejtuar biznesin e ndërmarrjes, përfshihet edhe xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse në fjalë. Në shembullin do të ishin marrë parasysh dy shoqëritë mëma (“c”)

të ndërmarrjes në fjalë (“a”) ashtu edhe shoqëritë respektive mëma (“c1” në shembullin e dhënë).

168. Njëra nga ndërmarrjet e kontrolluara nga “a” (e quajtur “b”) ka nga ana e saj ndërmarrje të kontrolluara vetë, domethënë “b1” dhe “b2”, dhe njëra nga ndërmarrjet mëma (e quajtur “c”) e cila ka edhe kjo një të kontrolluar (“d”).
169. Kritere specifike përcaktohen për ndërmarrjet, xhiroja e të cilave mund ti atribuohet ndërmarrjes në fjalë /pjesëmarrëse. Këto kritere, përfshirë edhe të “drejtën për të menaxhuar biznesin e ndërmarrjes”, nuk përputhen me konceptin e “kontrollit”. Ndryshimet janë më të theksuara në fushën e kontrollit faktik. Ndërsa në një situatë të varësisë ekonomike/ e cila sjell influencë përcaktuese mbi aktivitetin e njw ndërmarrje mund të përcaktohet një kontroll faktik (si më sipër), një ndërmarrje e kontrolluar në mënyrë ekskluzive është marrë në konsideratë mbi një bazë të faktit vetëm nëse është qartësisht e demonstruar se ndërmarrja pjesëmarrëse/në fjalë ka fuqinë për të ushtruar më shumë se gjysmën e të drejtave të votës ose për të caktuar më shumë se gjysmën e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës/asamblesë. Për sa i përket situatës së kontrollit të përbashkët, zbatohet në situata në të cilat ndërmarrjet që zotërojnë kontrollin kanë bashkërisht një të drejtë menaxhimi në bazë të të drejtave individuale të vetos. Megjithatë, llogaritja e xhiros/ pika 161 mw sipër nuk do të zbatohet në situatat në të cilat kontrolli i përbashkët verifikohet/ vërtetohet *de facto* si shkak i interesave domethënëse të përbashkëta midis aksionerëve të pakicës të ndërmarrjes së përbashkët mbi bazën e pjesëmarrjes të aksionerëve në asamble.

## 5.2 Shpërndarja/llogaritja e të ardhurave/xhiros të shoqërive të identifikuar

170. Në përgjithësi, e gjithë xhiroja/ të ardhurat e ndërmarrjes së kontrolluar pjesëmarrëse/ në fjalë do të merret në konsideratë pavarësisht nga përqindja efektive e pjesëmarrjes aksionere që ndërmarrja pjesëmarrëse zotëron në këtë ndërmarrje të kontrolluar. Në grafik do të merret në konsideratë e gjithë xhiroja/ të ardhurat e të kontrolluara (të quajtura “b”) nga ndërmarrja pjesëmarrëse (“a”).
171. Në rastin e sipërmarrjeve të përbashkëta midis dy ose më shumë ndërmarrjeve pjesëmarrëse, xhiroja e sipërmarrjes së përbashkët (në masën në të cilën është realizuar nëpërmjet aktivitetit me të tretët siç është sqaruar në pikën 153) duhet të shpërndahet në pjesë të barabarta ndërmjet ndërmarrjeve pjesëmarrëse, pavarësisht nga pjesëmarrja e tyre në kapital apo të drejtave të tyre të votës.
172. Praktika e ndjekur nga Komisioni Europian ka qenë ajo e shpërndarjes së llogarisë së ndërmarrjes pjesëmarrëse xhiron e sipërmarrjes së përbashkët mbi një bazë *per capita*/ sipas kapitalit sipas numrit të ndërmarrjeve të cilat ushtrojnë kontrollin e përbashkët. Në shembull, merret në konsideratë gjysma e xhiros së “b3”.
173. Për llogaritjen e xhiros duhet të kihet parasysh edhe situatat të cilat implikojnë/ përfshijnë një kalim nga kontroll i përbashkët në atë ekskluziv për të evituar/ shmangur

numërimin/ llogaritjen e dyfishtë të xhiros të sipërmarrjes së përbashkët. Edhe pse ndërmarrja përfutuese zotëron të drejta apo fuqi/ kompetenca në sipërmarrjen e përbashkët, xhiroja e aksionarit përfutues duhet të llogaritet pa xhiron/ të ardhurat e sipërmarrjes së përbashkët, dhe xhiroja e sipërmarrjes së përbashkët duhet të merret në konsideratë pa xhiron e aksionarit përfutues.

### **5.3 Shpërndarja/ llogaritja e xhiros/ të ardhurave në rastin e fondeve të investimit**

**174.** Ndërmarrja e investimit, si është specifikuar në pikën 11, përfton zakonisht kontrollin indirekt mbi shoqëritë e portofolit të zotëruar nga një fond investimesh. Në të njëjtën mënyrë, mund të supozohet se ndërmarrja e investimit ka indirekt fuqi dhe të drejta në veçanti se ka indirekt fuqinë për të ushtruar të drejtat e votës të cilat zotërohen nga fondi i investimit në ndërmarrjet në portofol.

**175.** Të njëjtat konsiderata/ arsyetime, (pika 11), mund të bëhen edhe nëse një ndërmarrje investimi ndërton/ themelon fonde të ndryshme investimi, potencialisht me investues të ndryshëm. Në përgjithësi, në bazë të strukturës organizative, në veçanti lidhjet ndërmjet ndërmarrjes së investimit e ortakut ose ortakëve me përgjegjësi të pakufizuar të fondeve të ndryshëm të investimit të organizuar si **shoqëri komandite**, ose dispozitave kontraktuale, më në veçanti marrëveshjet e konsulencës midis ortakut me përgjegjësi të pakufizuar ose fondit të investimit dhe ndërmarrjes së investimit, kjo e fundit do të ketë indirekt fuqinë për të ushtruar të drejtat e votës të zotëruar nga fondi i investimit në shoqëritë e portofolit ose do të ketë indirekt njëri nga fuqitë ose të drejtat e tjera të **parashikuara në pikën 161**. Në këto rrethana, ndërmarrja e investimit mund të ketë një strukturë kontrolli të përbashkët mbi fonde të ndryshme që ka themeluar; manaxhimi/ administrimi i përbashkët i fondeve të ndryshme nga ana e së njëjtës shoqëri investimi shpesh tregohet/shquhet me një markë të përbashkët për fondet.

**176.** Si rrjedhojë, një organizim i tillë i fondeve të ndryshme nga ana e ndërmarrjes së investimit mund të shkaktojë/ mund të bëjë që të merret në konsideratë xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve të portofolit të zotëruara nga fonde të ndryshme për të vlerësuar nëse janë arritur pragjet e xhiros të nenit 12 atëherë kur ndërmarrja e investimit përfton, nëpërmjet njërit prej fondeve, kontrollin indirekt/jo të drejtpërdrejtë të një shoqërie në portofol/të portofolit.

### **5.4 Shpërndarja/ llogaritja e xhiros në ndërmarrjet publike**

**177.** Për sa i përket llogaritjes së xhiros të ndërmarrjeve publike, “në sektorin publik, për llogaritjen e xhiros së një ndërmarrje e cila merr pjesë në përqendrim duhet të merren parasysh edhe shoqëri/ ndërmarrje të cilat përbëjnë një unitet/ njësi ekonomike të pajisur me një fuqi vendimmarrëse autonome, pavarësisht nga zotërimi i kapitalit ose nga dispozitat e kontrollit administrativ të cilat u aplikohen” për të evituar diskriminimin ndërmjet sektorit publik dhe atij privat.

**178.** Për të llogaritur xhiron e ndërmarrjeve publike, merren në konsideratë vetëm ndërmarrjet të cilat i përkasin të njëjtit unitet/ njësi ekonomike, d.m.th. që janë pjesë në të njëjtën fuqi vendimmarrëse autonome.

**179.** Kështu, p.sh. një ndërmarrje publike e cila nuk i është nënshtruar koordinimit me *holding* të tjera shtetërore duhet të trajtohet si një ndërmarrje e pavarur dhe xhironja e shoqërive të tjera me pronësi shtetërore nuk duhet të merret në konsideratë. Atëherë kur disa ndërmarrje publike megjithatë bëjnë pjesë nën profilin administrativ/menaxherial në të njëjtën qendër vendimmarrëse autonome, xhironja e tyre duhet të konsiderohet pjesë e asaj të grupit të ndërmarrjes pjesëmarrëse.

## **V. Shpërndarja gjeografike e xhiros/ të ardhurave**

**180.** Meqenëse llogaritë e audituara shpesh nuk japin të dhëna për një shpërndarje gjeografike do të bazohemi në shifrat më të mira të disponuara/ të dhëna nga ndërmarrjet. Xhironja e realizuar përfshin produktet dhe shërbimet e ofruara për ndërmarrjet apo konsumatorët.

### *Rregull i përgjithshëm*

**181.** Nuk ka dallim midis “produkteve të shitura” dhe “shërbimeve të ofruara” për qëllim të shpërndarjes gjeografike të xhiros. Në të dyja rastet, rregulli i përgjithshëm është se xhironja duhet të referohet vendit në të cilin gjendet klienti. Principi është që xhironja duhet të atribuohet vendit në të cilin zhvillohet konkurrenca me furnizuesit alternativ. Ky vend është zakonisht edhe vendi në të cilin duhet të jetë kryer elementi karakteristik i kontratës në fjalë, që do të thotë atje ku është ofruar efektivisht shërbimi dhe është dorëzuar efektivisht produkti. Në rastin e transaksioneve nëpërmjet Internetit /via internet, mund të jetë e vështirë për ndërmarrjet që të përcaktojnë vendin në të cilin gjendet klienti në momentin në të cilin kontrata është nënshkruar nëpërmjet Internetit. Nëse vetë produkti ose shërbimi nuk ofrohet nëpërmjet Internetit, për të evituar këto vështirësi është e mundur të referohesh vendit në të cilin ekzekutohet elementi karakteristik i kontratës/ thelbi/ objekti. Përafërsisht, shitja e mallrave dhe ofrimi i shërbimeve analizohen veçmas për sa kanë karakteristika të ndryshme në kuptim të ndarjes së xhiros.

### *Shitja e mallrave*

**182.** Për sa i përket shitjes së mallrave, mund të ketë situata të veçanta në rastet në të cilat vendi në të cilin ndodhet klienti në momentin e mbylljes së marrëveshjes së blerjes është i ndryshëm nga adresa e faturimit dhe/ ose nga vendi i dorëzimit. Në këto raste, vendi në të cilin është mbyllur marrëveshja e blerjes dhe vendi i dorëzimit janë më të rëndësishëm sesa adresa e faturimit. Pasi dorëzimi është zakonisht elementi karakteristik i shitjes së mallrave/të mirave, vendi i dorëzimit mund të mbizotërojë edhe mbi vendin në të cilin ndodhet klienti në momentin e mbylljes së marrëveshjes së blerjes. Kjo do të varet nga fakti nëse konsiderohet se vendi i dorëzimit është vendi në të cilin zhvillohet konkurrenca për shitjen e mallrave /të mirave apo nëse ajo zhvillohet në vendin ku ka rezidencën klienti. Në rastin e shitjes të sendeve të luajtshme, si një automobil, tek një konsumator

final, vendi në të cilin automjeti është dorëzuar klientit është themeltar edhe pse marrëveshja është mbyllur më parë në rrugë telefonike ose nëpërmjet Internet.

**183.** Një situatë e veçantë merr formë në rastet kur një ndërmarrje shumëkombëshe ndjek një strategji përftimi në shkallë komunitare dhe përmbush të gjitha kërkesat e veta për një mall/të mirë apo shërbim duke u pajisur/furnizuar vetëm në një lokalitet. Pasi një organizatë përftimi e centralizuar mund të marrë formë të ndryshme, është e nevojshme të konsiderosh formën pasi kjo mund të vendosë firmën e ndarjes së xhiros. Atëherë kur të mirat blihen nga organizata të përfimit të centralizuar dhe me vonë i dorëzohen po kësaj, dhe më pas rishpërndahen në nivel të brendshëm ndërmarrje disa impianteve të cilat ndodhen në Shtete anëtare, xhiroja i atribuohet vetëm Shtetit anëtar në të cilin ndodhet organizata e përfimit e centralizuar. Në këtë rast, konkurrenca zhvillohet në vendin ku është vendosur organizata e përfimit e centralizuar dhe ky është vendi në të cilin ekzekutohet elementi karakteristik i të kontratës së shitjes. Situata është e ndryshme në rastin kur ka lidhje direkt midis shitësit dhe shoqërive të ndryshme të kontrolluara. Në këtë kuadër/tipologji/skemë hyn edhe rasti në të cilin organizata e përfimit e centralizuar përmbyll një marrëveshje të thjeshtë kuadër, por porositë e veçanta janë bërë nga shoqëritë e kontrolluara në Shtete të ndryshme anëtare dhe produktet i dorëzohen direkt atyre, si edhe rasti në të cilin porositë e veçanta janë bërë nëpërmjet organizatës së përfimit të centralizuar, por produktet janë dorëzuar direkt shoqërive të kontrolluara. Në të dyja rastet xhiroja duhet ti atribuohet Shteteve të ndryshme anëtare në të cilët ndodhen shoqëritë e kontrolluara, pavarësisht nga fakti nëse faturat dhe pagesat bëhen nga shoqëritë e kontrolluara apo nga organizata e përfimit e centralizuar, pasi në të dyja rastet konkurrenca me furnizuesit alternativë bëhet/ndodh për dorëzimin në shoqëritë e ndryshme të kontrolluara edhe pse kontrata nënshkruhet/mbyllet në nivel qendror. Në rastin e parë, gjithashtu, shoqëritë e kontrolluara vendosin efektivisht për llogari të vetën për sa i përket sasive që duhet të dorëzohen dhe një elementi themelor për konkurrencën. (Kalimtare )

#### *Ofrimi i shërbimit*

**184.** Për sa i përket shërbimeve, parashikohet se vendi i i ofrimit për klientin duhet të jetë vendimtar. Është e mundur të ndahen shërbimet të cilat paraqesin elemente ndërkufitare në tre kategori të përgjithshme. Kategoria e parë përfshin rastet në të cilat ai që zhvendoset është furnizuesi i shërbimeve, e dyta janë rastet në të cilët është klienti ai që zhvendoset. Në kategorinë e tretë hyjnë rastet në të cilët shërbimi ofrohet pa nevojën që të zhvendoset as furnizuesi as klienti. Në dy kategoritë e para, xhiroja duhet ti atribuohet vendit të destinacionit të atij që kryen zhvendosjen, që do të thotë vendit në të cilin efektivisht shërbimi i është ofruar klientit. Në kategorinë e tretë, xhiroja/të ardhurat duhet përgjithësisht ti atribuohet lokalitetit në të cilin gjendet klienti. Për furnizimin e centralizuar të shërbimeve aplikohen për analogji parimet e sipërpërmendura për blerjen e centralizuar të të mirave.

**185.** Një shembull i kategorisë së parë do të ishte një situatë në të cilën një ndërmarrje jo evropiane ofron shërbime mirëmbajtje speciale për avionë një shoqërie udhëtimesh në një Shtet anëtar. Në këtë rast, furnizuesi i shërbimeve zhvendoset në Komunitetin evropian,

ku shërbimi është efektivisht i ofruar dhe ku zhvillohet edhe konkurrenca për këtë shërbim. Nëse një turist evropian merr me qira një automobil ose prenoton një hotel në Shtetet e Bashkuara, kjo skemë hyn në kategorinë e dytë pasi shërbimi është ofruar jashtë kufijve të Komunitetit evropian dhe konkurrenca zhvillohet ndërmjet hoteleve dhe shoqërive që ofrojnë makina me qira në lokalitetin e zgjedhur. Megjithatë, rasti është i ndryshëm për pushimet me formulën (*all inclusive*). Për këto lloj pushimesh, shërbimi nis me shitjen e paketës nëpërmjet një agjencie udhëtimesh në vendin në të cilin ndodhet klienti dhe konkurrenca për shitjen e udhëtimeve nëpërmjet një agjencie udhëtimesh ndodh në nivel lokal, si në rastin e blerjeve në detaj (të drejtpërdrejtë), edhe pse një pjesë e shërbimit mund të ofrohen në lokalitete të largët nga ky vend. Rasti pra bën pjesë në kategorinë e tretë dhe xhiroja duhet ti atribuohet vendit në të cilin ndodhet klienti. Kategoria e tretë përfshin edhe rastet si furnizimi i softëare-ve ose shpërndarja e filmave të prodhuar jashtë Komunitetit, por të ofruar/furnizuar një klienti në një Shtet anëtar në mënyrë që shërbimi efektivisht i ofrohet klientit brenda Komunitetit.

**186.** Rastet që i përkasin transportit të mallrave janë të ndryshëm përderisa klienti të cilit i ofrohen këto shërbime nuk zhvendoset: shërbimi i transportit i është ofruar klientit në vendin në të cilin ndodhet. Këto raste hyjnë në kategorinë e tretë dhe vendi në të cilin ndodhet klienti është kriteri kryesor për atribuimin e xhiros.

**187.** Në rastet që i përkasin telekomunikacioneve, klasifikimi i shërbimeve të terminimit të thirrjes mund të sjellë probleme. Edhe pse terminimi i thirrjes duket se hyn në kategorinë e tretë, ka motive për ta konsideruar në një mënyrë të ndryshme. Shërbimet e terminimit të thirrjes ofrohen, p.sh, kur thirrja origjinohet nga një operator evropian, terminohet në Shtetet e Bashkuara. Edhe pse nuk zhvendosen as operatori evropian dhe as ai i shteteve të bashkuara, sinjali udhëton dhe shërbimi ofrohet nëpërmjet rrjetit të shteteve të bashkuara tek operatori evropian në Shtetet e Bashkuara. Kjo është edhe vendi në të cilin ndodh efektivisht konkurrenca. Xhiroja në fjalë pra duhet të konsiderohet xhiro jo-komunitare.

### *Sektorë specifik*

**188.** Sektorë të veçantë, të paraqitur në seksionin VI të kësaj komunikate, megjithatë përbëjnë probleme të shumta specifike në kuptim të ndarjes gjeografike të xhiros.

## **VI. Konvertimi i xhiros në Euro/Lek**

**189.** Për konvertimin e shifrave të xhiros në euro, do të duhet të bëhet shumë kujdes me kursin e këmbimit të përdorur. Xhiroja vjetore e një shoqërie konvertohet me kursin mesatar për 12 muajt e fundit. Shuma të vërtetuara/verifikuara të xhiros vjetore duhet të konvertohen në bllok dhe jo të ndara në shuma tremestrale ose mujore të cilët konvertohen pastaj individualisht.

**190.** Procedura nuk ndryshon kur shoqëria kryen shitje në monedha të ndryshme. Xhiroja totale e pasqyruar në llogaritë vjetore të konsoliduara të shoqërisë dhe në valutën e përdorur duhet të konvertohet në euro me kursin mesatar vjetor. Nuk duhet të procedohet për të konvertuar direkt në euro atëherë kur shitjet e kryera të shprehura në monedhë



lokale nga momenti që këto shifra nuk janë marrë nga llogaritë e konsoliduara të vërtetuara të ndërmarrjes.

## **VII. Dispozita në lidhje me entet/institutet e kredisë dhe institucione të tjera financiare dhe ndërmarrje të tjera sigurimesh**

### **1. Fusha e aplikimit**

**191.** Për të pacaktuar konceptet e “enteve/institucioneve të kredisë” dhe “institucioneve të tjera financiare” është ndjekur praktika sa vijon:  
“enti/ institucioni i kredisë”: është një ndërmarrje aktiviteti i së cilës konsiston në marrjen nga publiku të depozitave ose fondeve të tjera të rimbursueshme dhe dhënia e kredive për llogari të vetë.”;  
“institut financiar”: është një ndërmarrje e ndryshme nga një ent/ institucion kredie aktiviteti kryesor i së cilës konsiston në marrjen e pjesëmarrjeve ose në ushtrimin e një apo më shumë prej aktiviteteve si më poshtë :

**192.** Institutet financiarë janë për pasojë, nga një anë, shoqëritë e pjesëmarrjes financiare dhe nga ana tjetër, ndërmarrjet që zhvillojnë rregullisht si aktivitet kryesor një ose më shumë aktivitete të cilat përfshijnë:

- Operacione të huadhënies (përfshirë edhe aktivitetet si kreditë e konsumit, kreditë hipotekore, *factoring*, etj.);
- Leasing/qira financiare;
- Shërbimet e pagesave;
- Nxjerrjen dhe menaxhimin e mjeteve të pagesës (karta krediti, çeqe *travellers*, letra krediti);
- Dhënia e garancive dhe angazhimeve të garancisë/firmës;
- Operacione për llogari të vet apo për llogari të klientëve në mjete të tregut monetar (çeqe, kambiale, certifikata/vërtetime depozite etj.) këmbime, mjete financiare me kushte dhe opsione, kontrata mbi kursin e këmbimit dhe të interesit, letra me vlerë;
- Pjesëmarrje në nxjerrjen e titujve dhe dhënien e shërbimeve të lidhura;
- Shërbime të ndërmjetësisimit financiar të tipologjisë *money broking*;
- Menaxhim ose konsulencë në administrimin e pasurive;
- Kujdestari dhe administrim të letrave me vlerë.

### **2. Llogaritja e xhiros**

**2.1 Llogaritja e xhiros e enteve/instituteve të kredisë (të ndryshëm nga shoqëritë e pjesëmarrjes financiare)**

**2.1.1 Konsiderata të përgjithshme**

**193.** Në përgjithësi nuk hasen vështirësi të veçanta në aplikimin e kriterit të të ardhurave për përkufizimin e xhiros **ndërkombëtare** të institucioneve të kreditit dhe institucioneve financiare.

### **2.1.2 Xhироja e shoqërive të leasing/qirasë financiare**

**194.** Duhet të bëhet një dallim thelbësor midis leasing/ qirasë financiar/e dhe leasing/ qirasë operative/zakonshme. Thelbësisht, operacionet e leasing/qirasë financiar bëhen për periudha më të gjata në krahasim me leasing/qirasë operative/zakonshme dhe në fund të periudhës së leasing-ut/qirasë pronësia zakonisht i transferohet qiramarrësit nëpërmjet një opsioni blerje të përfshirë në kontratën e qirasë. Në leasing/qiranë e operativ/zakonshme, në të kundërt, pronësia nuk transferohet tek qiramarrësi me skadencën e kontratës dhe kostot e mirëmbajtjes, riparimit dhe sigurimit të sendeve/të mirave objekt janë të përfshira në qira. Një operacion i qirasë financiare funksionon pra si një dhënie hua nga qiradhënësi për ti lejuar qiramarrësit që të blejë një të mirë.

**195.** Si është specifikuar më parë, një ndërmarrje që ka qira financiare si aktivitetin e saj kryesor është një institut financiar dhe xhироja e saj llogaritet sipas normave/dispozitive specifike të parashikuara në këtë dispozitë. **Merren në konsideratë të gjitha pagesat mbi kontratat e qirasë financiare, me përjashtim të pjesës në lidhje me mbylljen; nuk konsiderohet shitja e pagesave të ardhshme të qirasë në fillim të kontratës me qëllim ri-financimin.**

Megjithatë aktivitetet e qirasë së zakonshme nuk konsiderohen të dhëna nga institutet financiare;

### **2.2 Ndërmarrja e sigurimeve**

**196.** Për llogaritjen e xhiros së ndërmarrjeve të sigurimit, merren parasysh primet bruto. Primet bruto janë shuma e primeve të marrë/fituar, përfshirë edhe primet e ri-sigurimit të marrë/fituar nëse ndërmarrja në fjalë është aktive edhe në sektorin e ri-sigurimit. Primet e ri-sigurimit pasive, ose të gjithë shumat e paguara dhe për tu paguar nga ana e ndërmarrjeve pjesëmarrëse për të përfituar mbulimin e ri-sigurimit, janë vetëm kosto në lidhje me furnizimin/ofrimin e mbulimit të sigurimit dhe nuk i zbriten nga primet bruto.

**197.** Primet që duhet të merren në konsideratë janë jo vetëm ata në lidhje me kontratat e reja të sigurimeve të nënshkruara gjatë vitit ushtrimor të marrë në konsideratë, por edhe të gjithë primet e lidhura me kontratat e nënshkruara në vitet ushtrimore të mëparshëm të cilat mbeten në fuqi gjatë kësaj periudhe.

**198.** Për të themeluar/ndërtuar rezerva të mjaftueshme të cilat lejojnë likuidimin e dëmeve, ndërmarrjet e sigurimit zakonisht kanë një portofol investimi në aksione, tituj me vlerë, terrene dhe pronësi të paluajtshme dhe aktivitete të tjera, nga të cilat marrin të ardhura vjetore. Të ardhurat vjetore nga këto burime nuk konsiderohen si xhiro për ndërmarrjet e

sigurimit. Gjithsesi është e nevojshme të dallohet midis investimeve financiare të pastra, të cilat nuk i sjellin ndërmarrjes së sigurimit të drejtat dhe kompetencat sipas pikws 161 në ndërmarrjet në të cilat është bërë investimi, nga investimet që sjellin blerjen e një pjesëmarrje. Në rastin e dytë xhiroja e ndërmarrjes së kontrolluar ose të lidhur i shtohet xhiros së ndërmarrjes së sigurimit, me qëllim që të përcaktohen kufijtë e përcaktuar

### 2.3 Shoqëritë e pjesëmarrjes financiare

199. Përderisa bëjnë pjesë tek “institute të tjera financiare” xhiroja e shoqërisë e/me pjesëmarrjes financiare llogaritet duke zbatuar normat/dispozitat specifike për këtë rast.

200. Praktikisht, në fillim merret në konsideratë xhiroja (jo e konsoliduar) e shoqërisë së/me pjesëmarrjes financiare. Më pas i shtohet xhiroja e ndërmarrjeve duke pasur parasysh që t’i zbritet dividendët e mundshëm dhe fitime të tjera që këto ndërmarrje i kanë shpërndarë shoqërisë së/me pjesëmarrjes financiare. Më poshtë sillet një shembull i kësaj llogaritje:

201. Për këto llogaritje është e mundur që të merren në konsideratë norma/ dispozita të ndryshme të kontabilitetit. Edhe pse kjo vlen për çdo lloj ndërmarrje së cilës i aplikohet ligji dhe rregullorja, ajo është veçanërisht e rëndësishme në rastin e shoqërive të pjesëmarrjes financiare, ku vlerësohet me kujdes numri dhe varieteti i ndërmarrjeve të kontrolluara dhe grada e kontrollit që holding-u ushtron mbi të kontrolluarat, të lidhurat dhe pjesëmarrëse të tjera.

202. Llogaritja e xhiros për ndërmarrjet e/ me pjesëmarrje financiare të përshkruara më sipër mund të jetë e vështirë në praktikë. Prandaj do të jetë e nevojshme të aplikohet në mënyrë rigoroze dhe të detajuar vetëm në rastet në të cilat duket e mundshme që xhiroja e një holding-u financiare i afrohet pragjeve të përcaktuar në ligj; përkundrazi atëherë kur është e dukshme se xhiroja është dukshëm më e lartë ose më e ulët se pragjet e nenit 12 të ligjit, të dhënat e bilancit të publikuar do të jenë të mjaftueshme për të përcaktuar kompetencën/juridiksionin.

## Aneks – Shënime fundore

- <sup>1</sup> Një përqendrim nuk ndodh nëse kompania në fjalë është përqendruar me një degë të ndërmarrjes përfutuese duke pasur efektin që kompania mëmë përfiton kontrollin e ndërmarrjes në fjalë.
- <sup>2</sup> Në përcaktimin e pavarësisë së mëparshme të një ndërmarrjeje, çështja e kontrollit mund të jetë relevante siç përqendrimi mundet të jetë vetëm një ristrukturim i brendshëm brenda grupit. Në këtë kontekst specifik, vlerësimi i kontrollit ndjek konceptin e përgjithshëm si më poshtë dhe përfshin kontrollin *de jure* ashtu si dhe atë *de facto*.
- <sup>3</sup> Përfshirë dhe vetë shtetin.
- <sup>4</sup> Një individ privat përfiton kontrollin e përbashkët dhe nuk konsiderohet si ndërmarrja në fjalë.
- <sup>5</sup> Kjo strukturë ka gjithashtu efekt mbi faktin se si xhiroja llogaritet në situatat që përfshijnë fondet e investimit.
- <sup>6</sup> Ka raste ku marrëveshja e menaxhimit ka një kohëzgjatje prej 10-15 vitesh, dhe ku kontrata ka një kohëzgjatje prej 8 vjetësh.
- <sup>7</sup> Dhënia e licencave dhe transferimi i licencave të patentës do të përbëjë një përqendrim nëse kjo është bërë mbi baza të qëndrueshme. Në këtë aspekt do të zbatohen kushtet e vendosura sipas paragrafit 14 për përfitim të kontrollit në lidhje me marrëveshjen afatgjatë.
- <sup>8</sup> Shiko rastin e joint ventures, Rasti COMP/M.2903 — DaimlerChrysler/Deutsche Telekom/JV i 30 Prill 2003 ku për një periudhë prej 12 vitesh ishte konsideruar si e mjaftueshme; Rasti COMP/M.2632 — Deutsche Bahn/ECT International/United Depots/ JV i 11 Shkurt 2002 me një kontratë që zgjati 8 vjet. Në rastin COMP/M.3858 Lehman Brothers/Starwood/LeMeridien e 20 Korrik 2005, Komisioni i konsideroi periudhën minimale prej 10-15 vitesh të mjaftueshme por jo periudhën prej 3 vitesh. Përfitimi i kontrollit nëpërmjet përfimit të aksioneve ose asetëve normalisht nuk kufizohet me një periudhë të caktuar kohore dhe si e tillë supozohet se çon në një ndryshim kontrolli mbi baza të qëndrueshme. Vetëm në skenarët që paraqiten nën paragrafin 29 ff., një përfitim kontrolli i aksioneve ose asetëve do të konsiderohet në mënyrë përjashtimore si tranzitor për sa i përket natyrës dhe si i tillë nuk do çojë në një ndryshim të qëndrueshëm të kontrollit të ndërmarrjes në fjalë.
- <sup>9</sup> Shiko rastin M.2389 — Shell/DEA të datës 20 Dhjetor 2001 ku përfutuesi i fundit i kontrollit të vetëm kishte një influencë të fortë në menaxhimin operacional përgjatë periudhës së kontrollit të përbashkët. Rasti M.2854 — RAG/Degussa e datës 18 Nëntor 2002 ku periudha transitore është dizenuar për të lehtësuar ristrukturimin e brendshëm pas përqendrimit.
- <sup>10</sup> Kjo gjithastu ka të bëjë më rastet kur një ndërmarrje shet një biznes të një blerës dhe në këtë mënyrë përfiton shitësin përfshirë edhe biznesin e shitur. Shiko rastin COMP/M.4521-LGI/Telenet të datës 26 shkurt 2007.
- <sup>11</sup> Ndërvarësia bazohet mbi faktin se dy transaksione janë vendosur dhe ndërmarrë njëkohësisht dhe që në varësi të qëllimeve ekonomike të palëve, secili nga transaksionet nuk do të ishte ndërmarrë pa tjetrin.
- <sup>12</sup> Në BE ka pasur raste ku të gjitha asetet ishin përdorur gjithashtu në të njëtin treg produkti. Të njëjtat konsiderata zbatohen nëse një jonit venture krijohet nga disa kompani, duke formuar një biznes të vetëm; ndërvarësia e transaksioneve të krijuara, respektivisht një jonit venture prodhimi dhe shpërndarjeje ishin të nevojshme me qëllim që të demonstrojnë që kishte një përqendrim të vetëm që mund të krijonte një jonit venture me shumë funksione.
- <sup>13</sup> Kjo zbatohet për situatat ku kontrolli i vetëm është përfutur kur vetëm pjesë të ndërmarrjes më parë ishin kontrolluar bashkërisht nga ndërmarrja përfutuese.
- <sup>14</sup> Përderisa ky aksioner është e vetmja ndërmarrje që përfiton një influencë kontrolluese, vetëm ky aksioner është i detyruar që të paraqesë një njoftim sipas rregullores së përqendrimeve.
- <sup>15</sup> Një joint venture mban një aksion në një kompani nga e cila kishte kontrollin e vetëm negativ mbi këtë kompani.
- <sup>16</sup> Në përgjithësi, duhet të kihet parasysh se Komisioni nuk do ta vlerësojë si një përqendrim të ndarë zëvendësimin indirekt të aksionarëve kontrollues në një skenar kontrolli të përbashkët i cili ndodh nëpërmjet një përfitimi kontrolli të një nga ndërmarrjeve të veta mëmë. Komisioni do të vlerësojë çdo ndryshim që ndodh në një situatë konkurruese të një joint venture në kuadrin e një përfitimi të përgjithshëm të kontrollit të ndërmarrjeve të tija mëmë. Në këto rrethana, aksionarët e tjerë kontrollues në joint venture si rrjedhojë nuk do të jenë ndërmarrje që kanë lidhje me përqendrimin i cili lidhet me ndërmarrjet e tija mëmë.

- 17 Një rast i veçantë ekziston kur shitjet nga joint venture tek kompanitë mëmë janë shkaktuar nga një monopol ligjor në rrjedhën e sipërme të joint venture, , ose kur shitjet tek kompania mëmë konsiston tek nën-produktet, të cilat kanë një rëndësi të vogël për joint venture,
- 18 Pyetja se bazuar në çfarë rrethanash një marrëveshje që kërkon burime nga jashtë shoqërisë cilësohet si përqendrim trajtohet në paragrafin 25ff. të këtij njoftimi.
- 19 Ngjarja që përcakton nevojën për njoftim në këtë rast do të jete marrëveshja ose një akt tjetër juridik në baze të transferimit të aktiveve, kontrata, kooë-hoë ose të drejta të tjera.
- 20 Në këtë rast nuk përjashtohet vlerësimi i faktit nëse ndryshimi kërkon apo jo paraqitjen e provave të mëtejshme përpara Komisionit
- 21 Vetëm një palë nuk kishte më si qëllim që të zbatonte më një marrëveshje, ndërsa tjetra vazhdonte ta konsideronte të detyrueshme dhe të aplikueshme.
- 22 Identiteti i palëve njoftuese ndryshon, përderisa në rastin e bashkimit (shkrirjes) njoftimi bëhet nga të dyja palët, ndërsa më rastin e përfutimit të kontrollit njoftimi duhet të depozitohet vetëm nga pala që përfiton kontrollin. Megjithatë, nëse palët përftojnë kontrollin e një ndërmarrje dhe vendosin më vonë të shkrihen /bashkohen me të kontrolluarën të sapo përfutur, ky operacion duhet të konsiderohet si një ristrukturim i brendshëm i cili nuk shkakton ndryshim të kontrollit dhe nuk përfshihet pra në fushën e aplikimit të nenit 3 të rregullores mbi përqendrimet.
- 23 Hipotizojmë situatën e mëposhtme: shoqëria objekt i operacionit ka një xhiro komunitare më të vogël se 250 milionë Euro dhe përfutuesit janë dy (ose më shumë ) shoqëri, secila prej tyre ka një xhiro komunitare më të madhe se 250 milion Euro. Nëse shoqëria përftohet nga një “kuti bosh” e themeluar nga shoqëritë përfutuese, do të ishte vetëm një shoqëri (“kutia bosh”) me xhiro komunitare me më shumë se 250 milion Euro dhe për rrjedhojë nuk do të përmbushej njëra nga kushtet kumulative përkatëse të pragut të xhiros përtej së cilës shkaktohet kompetenca e Komitetit (ose ekzistenca e të paktën dy shoqërive me xhiro komunitare mbi 250 milion Euro). Në të kundërt, nëse në vend që të operohet nëpërmjet “kutise bosh” ndërmarrjet përfutuese të përfitonin/ blenin direkt ndërmarrjen, kushtet për pragun e xhiros do të përmbusheshin dhe këtij opresioni do ti aplikohesh rregullorja e përqendrimeve. Të njëjtat arsyetime vlejné edhe për pragjet në nivel kombëtar, neni 1, paragrafi 3.
- 24 Një person fizik me aktivitete të tjera ekonomike ka përfutur kontrollin e përbashkët tek një ndërmarrje dhe është konsideruar si ndërmarrje pjesëmarrëse.
- 25 Shih, duke konsideruar 22 të rregullores se BE-se mbi përqendrimet, të lidhur drejtpërdrejtë me llogaritjen e xhiros të një ndërmarrje pjesëmarrëse me pronësi publike.
- 26 Mundësia alternative që xhiroja duhet të përcaktohet në datën e fundit kur palët pjesëmarrëse janë të detyruara të paraqesin njoftimin (shtatë ditë pas “ngjarjes vendimtare” në kuptim të rregullores së mëparshme për përqendrimet) nuk mund të mbahet në rregulloren për përqendrimet i ndryshua, përderisa nuk asnjë afat për njoftimin.
- 27 Një ndërmarrje nuk vepron zakonisht vetëm si ndërmjetës, nëse shet produkte nëpërmjet një akti tregtar i cili përfshin transferim të pronësisë.
- 28 Komisioni European ka vendosur të konsiderojë disa fitime të veçanta të ardhura nga aktiviteti i dhënies me qira të automobilave si fitime të ardhura nga aktivitete të zakonshme edhe pse ishin të përfshira si “produkte të tjera të menaxhimit të ndërmarrjes” në llogarinë e fitimeve dhe humbjeve të Éagons-Lits.
- 29 Komisioni European ka përjashtuar ndihmën komunitare nga llogaritje e xhiros sepse ndihma në fjalë ishte e destinuar të mbështeste jo shitjen e produkteve të një nga ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqendrim, por produktet e lëndëve të para (fara) të përdorura nga ndërmarrja, e cila ishte e specializuar në blurajen e farave.
- 30 Për qëllime të grafikut është supozuar që ndërmarrja pjesëmarrëse është vetë ndërmarrja e përbashkët sipas kritereve të përcaktuar në pikën 146 (përfitim nga ana e një ndërmarrje të përbashkët me titull të plotë e cila operon në të njëjtin treg).
- 31 Kjo nuk influencon mbi xhiron që operatori telefonik/së european gjeneron kundrejt klientit të tij me thirrjen.
- 32 Parimet e vendosura duke iu referuar shoqërive të/me pjesëmarrje financiare në një farë mase mund t’i aplikohen shoqërive të menaxhimit të fondeve.

33

milion euro

1. Xhiroja në lidhje me aktivitetet financiare (nga llogaritë e pa konsoliduara) 3 000
2. Xhiroja në lidhje me ndërmarrjet e sigurimit (primet bruto) 300

3. Xhiroja e ndërmarrjeve industriale dhe të ardhura të tjera nga ndërmarrjet 2 dhe 3  
<200>  
Xhiroja totale e ndërmarrjes me pjesëmarrje financiare dhe e grupit të saj 5 1 00